

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5911
E mërkurë, 23 tetor 2019
çmimi 0.40 €

Migrimet ilegale, pengesë serioze për liberalizimin e vizave

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

KONSPIRACIONET E VJETRA SI GOGOL PËR NJË KONFIGURACION TJETËR POLITIK NË KOSOVËS F. 11

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE

EKIPET E UJËSJELLËSIT NË AKSION, KONTROLLOJNË KEQPËRDORIMET E MUNDSHME F. 6

NË KËTO QYTETE PARTITË DOLËN TË PARAT F. 6

EKONOMI

DELEGACIONI I BQK-së PËRFUNDON PJESËMARRJEN NË TAKIMET VJETORE TË FMN-së DHE BB-së F. 9

KULTURË

BASRIE MURATI-SAKIRI MERR PJESË NË FESTIVALIN E LIBRIT DHE LETËRSISË NË ZURICH F. 18

Lulëzim ETEMAJ

SPORT

13 GJIMNASTË E PËRFAQËSOJNË KOSOVËN NË SLOVENI F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", HYSNI GUCATI | FAQE 4-5

OVLUÇK-ja nuk i përjashton protestat

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, nuk e ka përjashtuar mundësinë e organizimit të protestave për shkak të numrit të madh të ftesave të Gjykatës Speciale për ish-ushtarët dhe eprorët e UÇK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se për këtë çështje shumë shpejt do t'i mbledhin kryesinë dhe këshillin drejtues të OVLUÇK-së. Ai ka treguar se vetëm në javën e fundit mbi 40 ish-pjesëtarë të UÇK-së kanë marrë ftesa për intervistim. Gucati ka paralajmëruar se në ditët e ardhshme mund të ketë edhe disa arrestime



Akademia Diplomatike fillon trajnimin intensiv për diplomatë të rinj

FAQE 3



Pesëmbëdhjetë diplomatë të rinj të martën kanë filluar trajnimin intensiv për ngritjen e shkathtësive për të shërbyer në misionet përkatëse diplomatike dhe konsullore të shërbimit të jashtëm të Republikës së

Kosovës. Ky trajnim do të zgjasë 20 ditë dhe aty do të ligjërojnë zyrtarë të Qeverisë së Kosovës, përfaqësues të ambasadave dhe konsullatave të huaja në Kosovë si dhe ekspertë ndërkombëtarë e vendorë



Shpallet konkursi për rekrutimin e kadetëve të FSK-së për studime në ShBA | FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Italia tenton ta bindë BE-në për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut

ROMË, 22 TETOR - Italia po lufton që ta mbajë në tryezë mundësinë e zgjerimit të BE-se me vende të Ballkanit perëndimor. Më 29 tetor, kryeministri maqedonas Zoran Zaev udhëton drejt Romës, ndërsa shefi i ekzekutivit italian, Giuseppe Conte, që javën e kaluar ishte në Tiranë, po vazhdon përpjekjet e tij pavarësisht prej refuzimit të Francës për t'i çelur negociatat e anëtarësimit Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Udhëtimi i Zaevit vjen përpara takimit të Këshillit të Ministrave të BE-së që duhet të zhvillohet më 19 nëntor, kur Italia dhe vendet e tjera anëtare të bllokut pritet të bëjnë

presion për një diskutim të ri të çështjes së zgjerimit, shkruan Bim, duke komentuar nismën italiane. "Tani do të ngadalësoj pak me shpresën dhe optimizmin tim sepse isha optimisti më i madh se Këshilli Evropian do të aprovonte një datë. Le të punojmë në shtëpi dhe të shpresojmë që BE-ja do t'i çelë kapitujt tanë e të marrë një vendim për fillimin e negociatave", tha Zaevi.

Qeveria e tij tani po përgatitet për zgjedhje të parakohshme në mars pasi kundërshtimi i Francës ia mohoi Tiranës dhe Shkupit një datë për nisjen e bisedimeve. Mes vendeve anëtare pati mosmar-

rëveshje që treguan se vetë politika e zgjerimit të BE-së është në një konfuzion. "Këshilli Evropian do t'i kthehet çështjes së zgjerimit përpara samitit BE-Balkan Perëndimor në Zagreb në maj 2020", u tha në deklaratën e lëshuar pas takimit. Por, kryeministri italian Conte la të kuptohet të premten se mund të ketë një iniciativë të re. Duke e quajtur zhvillimin "një gabim historik", Conte tha se do të propozojë që Bashkimi Evropian t'i rifillojë bisedimet në nëntor për zgjerimin e bllokut për ta përfshirë Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.



Liderët e BE-së kritikojnë mossuksesin e bllokut me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriore

STRASBURG, 22 TETOR - Udhëheqës të Bashkimit Evropian kritikuan vendimin e bllokut për mosdhënie të datës Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE. "Për mendimin tim, ky ka qenë gabim", tha presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, në një seancë të Parlamentit Evropian të martën në Strasburg. "Tani vetëm mund të shpresoj se udhëheqësit do t'i nxjerrin përfundimet e duhura kur të diskutojnë për procesin e pranimit para samitit në Zagreb që do të mbahet në maj të vitit 2020", tha Tusk.

Liderët e vendeve të BE-së nuk arritën të marrin një vendim pozitiv për hapjen e bisedimeve të pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë në një samit që u zhvillua javën e kaluar. Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, thuhet se ka bllokuar vendimin, duke kërkuar fillimisht reformim të BE-së.

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker, tha të



martën se Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria kanë pasur të drejtë t'i nisnin negociatat me BE-në dhe se kanë bërë përpjekje të mëdha në këtë drejtim.

Juncker tha se moshapja e negociatave ishte gabim i rëndë, sepse i godet këto dy vende "në zemrat

e tyre". "Është gabim i rëndë edhe për faktin se krijon përshtypjen se ju bëni premtime, nuk i realizoni ato dhe askush në botë nuk do të na respektojë", tha Juncker.

Pas mungesës së vendimit pozitiv nga BE-ja, Maqedonia e Veriut

shpalli zgjedhje të parakohshme parlamentare, të cilat do të mbahen në prill të vitit të ardhshëm. Ndërkaq, Parlamenti Evropian ka hartuar një draftrezolutë mbi bllokimin që i bëri Franca hapjes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë dhe Maqedonisë së

Veriut në BE.

Në dokument theksohet se refuzimi për t'ua dhënë dy vendeve dritën e shumëpritur jeshile të nisjes së bisedimeve mund të sjellë destabilitet jo vetëm në Shqipëri e Maqedoninë Veriore, por në mbarë rajonin.

Aty shprehet "keqardhje për vendimin e bllokimit të negociatave për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë si dhe për rolin që presidenti i Francës dhe vende të tjerë anëtare patën në këtë vendim". Në rezolutë i bëhet thirrje Këshillit Evropian ta marrë përgjegjësinë që i takon dhe të veprojë sipas angazhimeve që ai vetë ka marrë. Aty kujtohet se si Komisioni Evropian e ka rekomanduar që në 2009-n çeljen e negociatave me Shkupin, ndërsa thekson rezultatet me përfitime reciproke të gati "dy dekadash ndërveprimi institucional dhe politik mes BE-së dhe dy vendeve në fjalë".

Drafti i rezolutës, i formuluar të martën, mund të ndryshojë sot (e mërkurë).

Rama ta mbajë të njëjtin qëndrim si Zaevi

TIRANË, 22 TETOR - Mbledhja e Kryesisë e PS-së ka prodhuar reagime të forta nga ish-ministri Fatmir Xhafaj dhe ministri Pandeli Majko. Mungesa e një debati konstruktiv, pas dështimit për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE, ka sjellë reagimin e Fatmir Xhafajt, i cili ka qenë kritik ndaj kryeministrit Rama.

Ministri Majko ka mbështetur hapur ish-ministrin Xhafaj, duke kërkuar me insistim se duhet edhe

Edi Rama të ketë një qasje si kryeministri maqedonas Zaev, i cili e çoi vendin në zgjedhje të parakohshme parlamentare më 12 prill 2020 me qeveri tjetër, që quhet qeveri zgjedhore.

Madje, ministri Majko ka kritikuar edhe ministrin në detyrë Gent Cakaj për deklaratat e tij, ku tha se kryeministri Rama nuk pati premtuar se nëse nuk hapen negociatat do të japë dorëheqje si kryeministri maqedonas.

Insistimit të ish-ministrit të suksesshëm Fatmir Xhafaj i është përgjigjur vetë kryeministri Rama i cili ka theksuar se "edhe DASH-ina mbështeti ne si qeveri".

Në fakt, Pandeli Majkon e shikojnë me xhelozë në Rilindje, sepse ai mbetet një kandidaturë për kryeministër për qeveri të gjithëpranuar nga partitë politike shqiptare nëse shkohet në zgjedhje të parakohshme parlamentare në muajin maj 2020.



Akademia Diplomatike fillon trajnimin intensiv për diplomatë të rinj



Pesëmbëdhjetë diplomatë të rinj të martën kanë filluar trajnimin intensiv për ngritjen e shkathtësive për të shërbyer në misionet përkatëse diplomatike dhe konsullore të shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës. Ky trajnim do të zgjasë 20 ditë dhe aty do të ligjërojnë zyrtarë të Qeverisë së Kosovës, përfaqësues të ambasadave dhe konsullatave të huaja në Kosovë si dhe ekspertë ndërkombëtarë e vendorë

shkathtësive të diplomatëve të rinj. "Nuk do të ndalemi me kaq, por do ta vazhdojmë trajnimin edhe të kategorive të tjera të të punësuarve në Ministrinë e Punëve të Jashtme, të zyrtarëve të mesëm e të lartë, përfshirë edhe pjesën menaxheriale. E theksoj këtë, pasi në ditët e sotme, kohën e zhvillimeve të jashtëzakonshme në të gjitha fushat e jetës, në veçanti në fushën e komunikimit, duhet të jemi të kujdesshëm që të mos ngelim mbrapa, por të mëso-

jmë në vazhdimësi në mënyrë që të ecim në hap me të tjerët", ka theksuar Sadiku, i cili më pas ka mbajtur edhe një ligjëratë për strukturën organizative dhe funksionimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës. Në këtë trajnim 20 ditorë do të ligjërojnë zyrtarë të Qeverisë së Kosovës, përfaqësues të ambasadave dhe konsullatave të huaja në Kosovë, si dhe ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë. Ndërsa diplomatët e

rinj pritet që nga ky trajnim të arrijnë ta kuptojnë rëndësinë e koordinimit dhe përfaqësimit të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës si dhe t'i marrin njohuritë themelore lidhur me përfaqësimin e intereseve të shtetit të Kosovës jashtë vendit, duke përfshirë shërbimin konsullor dhe përfaqësimin diplomatik nga ambasadat e akredituara në vendet e ndryshme me të cilat Republika e Kosovës ka marrëdhënie diplomatike.

**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**


PRISHTINË, 22 TETOR - Pesëmbëdhjetë zyrtarë të rinj diplomatikë dhe zyrtarë të rinj civilë të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) të martën kanë filluar trajnimin intensiv i cili ka për qëllim ngritjen e shkathtësive të tyre përpara se të angazhohen që të shërbejnë në misionet përkatëse diplomatike dhe konsullore të shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës.

Hapjen e trajnimit, i cili do të jetë 20 ditorë, e ka bërë drejtori i përgjithshëm i Akademisë Diplomatike të Republikës së Kosovës, Fatmir Haxholli. Ai ka thënë se trajnimi i organizuar nga Akademia Diplomatike dhe mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme do t'i forcojë më shumë kapacitetet e Kosovës për t'i mbrojtur dhe promovuar interesat shtetërore dhe për të marrë pjesë në mënyrë efektive në ambientin ndërkombëtar.

Haxholli ka theksuar se ky është një moment i rëndësishëm meqë, siç ka thënë ai, programi nëpër të cilin do të kalojnë diplomatët e rinj është gjithëpërfshirës, i dalë si rezultat i konsultimeve brenda ministrisë, sugjerimeve prej aktorëve të shoqërisë civile që

monitorojnë punën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, konsultimeve me njohës të zhvillimeve në politikën e jashtme dhe diplomaci dhe është i bazuar edhe te modelet e shumta të akademive të vendeve të zhvilluara e demokratike. "Është nder ta mbani titullin Diplomatë të Rinj të Republikës së Kosovës, në kuptimin e gradës, edhe pse ju nuk jeni të rinj në atë që posedoni dhe përfaqësoni. Prandaj uroj që në një të ardhme të afërt do ta keni mundësinë që t'i dëshmoni me sukses aftësitë dhe shkathtësitë tuaja në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës", u ka thënë diplomatëve të rinj drejtori i Akademisë Diplomatike, Fatmir Haxholli.

I pranishëm në hapjen e këtij trajnimi ishte edhe sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Fitim Sadiku, i cili ka thënë se ky do të jetë vetëm një nga trajnimet në vazhden e trajnimeve të tjera që do të organizohen nga Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës. Ai ka theksuar se Akademia Diplomatike do të vazhdojë të lidhë marrëveshje me akademi të tjera diplomatike me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe ekspertëve më të mirë që do të kontribuojnë në forcimin e



Presidenti Thaçi merr pjesë në ceremoninë e kurorëzimit të Perandorit Naruhito

TOKYO, 22 TETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, po merr pjesë në ceremoninë shtetërore të kurorëzimit të Perandorit Naruhito. Perandori Naruhito në një cere-

moni të vjetër me traditë 1000-vjeçare, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësuesit më të lartë të 180 vendeve të botës, ka promovuar marrjen e fronit perandorak që e ka trashëguar në prill

të këtij viti, pas abdikimit të atit të tij, Perandorit AKihito. Në mëbrëmje presidenti Thaçi do të marrë pjesë edhe në ceremoninë zyrtare në Pallatin e Perandorit.

Flet për "Epokën e re", Hysni Gucati

OVLUÇK-ja nuk i përjashton



Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, nuk e ka përjashtuar mundësinë e organizmit të protestave për shkak të numrit të madh të ftesave të Gjykatës Speciale për ish-ushtarët dhe eprorët e UÇK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se për këtë çështje shumë shpejt do t'i mbledhin kryesinë dhe këshillin drejtues të OVLUÇK-së. Ai ka treguar se vetëm në javën e fundit mbi 40 ish-pjesëtarë të UÇK-së kanë marrë ftesa për intervistim. Gucati ka paralajmëruar se në ditët e ardhshme mund të ketë edhe disa arrestime

javën e fundit mbi 40 ish-pjesëtarë të UÇK-së kanë marrë ftesa për intervistim. "Ne kemi thënë me kohë se nuk e pranojmë Gjykatën Speciale. Kjo gjykatë është puro politike dhe e njëanshme. Është e vërtetë se vetëm në javën e fundit mbi 40 ftesa për intervistim kanë marrë ish-ushtarët dhe ish-eprorët e lartë të UÇK-së. Sa kam informacione, vetëm gjatë ditës së martë mbi shtatë ftesa janë shpërndarë", është shprehur ai, duke paralajmëruar se në ditët e ardhshme mund të ketë edhe disa arrestime. "Shpresoj të jem gabim, por flitet se mund të ndodhin tre ose katër arrestime këtë muaj apo në fillim të muajit tjetër. Dashtë Zoti mos të jetë e vërtetë!", ka deklaruar Gucati.

"Epoka e re": Z. Gucati, dhjetëra ish-ushtarë të UÇK-së kanë marrë ftesa nga Gjykata Speciale. *Komenti juaj?*

Gucati: Ne kemi thënë me kohë se nuk e pranojmë Gjykatën Speciale. Kjo gjykatë është puro politike dhe e njëanshme. Është e vërtetë se vetëm në javën e fundit mbi 40 ftesa për intervistim kanë marrë ish-ushtarët dhe ish-eprorët e lartë të UÇK-së. Sa kam informacione, vetëm gjatë ditës së martë mbi shtatë ftesa janë shpërndarë.

"Epoka e re": Cili është mesazhi i organizatës që drejtoni për veteranët që kanë marrë ftesa?

Gucati: Mesazhi im për ta është se ish-ushtarët e UÇK-së e kanë treguar veten në ditët më të vështira të luftës dhe do të dinë

EPOKA E RE **Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 22 TETOR - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka bërë me dije se, pas ftesave të shumta të Gjykatës Speciale për ish-pjesëtarët e UÇK-së, mund të organizohen

protesta. Ai ka deklaruar se për këtë çështje shumë shpejt do të mbledhen kryesia dhe këshilli drejtues i OVLUÇK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gucati ka treguar se nuk e kanë pritur një numër kaq të madh të ftesave për intervistë. "Natyrshisht se kemi menduar edhe për këtë çështje. Shumë shpejt do të ulemi

me kryesinë dhe këshillin drejtues të OVLUÇK-së të bisedojmë. Ne nuk e përjashtojmë mundësinë e protestave, por për këtë çështje vendimin do ta marrin kryesia dhe këshilli drejtues i OVLUÇK-së", ka thënë Gucati. Edhe një herë ai ka vlerësuar se kjo gjykatë është politike dhe e njëanshme. Sipas tij, vetëm në

protestat

pjesë e luftës nuk mund të flas asgjë.

"Epoka e re": A e keni pritur një numër kaq të madh të këtyre ftesave?

Gucati: Nuk e kemi pritur një numër të tillë të ftesave. Unë vetëm kam paralajmëruar më herët se muaji shtator dhe tetor do të jenë muaj shumë të nxehtë për ish-pjesëtarët e UÇK-së dhe të OVLUÇK-së. Dhe, doli ashtu.

"Epoka e re": Në çka e keni bazuar këtë paralajmërim?

Gucati: Nuk kishim informata paraprake sepse nuk bashkëpunojmë me Gjykatën Speciale. Por, prej themelimit të kësaj gjykate e kemi ditur se kjo gjykatë është e njëanshme. Nga takimet me ndërkombëtarët që i kemi pasur në zyrë dhe në bazë të fjalëve të tyre, e kemi ditur se do të ketë ftesa të tilla.

"Epoka e re": Pritni të ndalet apo të vazhdojë ky trend i ftesave?

Gucati: Qysh po shihet, s'e ka rendin të ndalet, por të vazhdojë edhe më tutje. Është reale që këto ditë të kemi edhe një mori ftesash të kësaj gjykate për ish-pjesëtarët e UÇK-së si dhe për individë që kanë qenë civilë.

"Epoka e re": Më herët keni paralajmëruar se mund të ketë edhe arrestime?

Gucati: Shpresoj të jem gabim, por flitet se mund të ndodhin tri ose katër arrestime këtë muaj apo në fillim të muajit tjetër. Dashtë Zoti mos të jetë e vërtetë!

"Epoka e re": OVLUÇK-ja çdoherë ka qenë e gatshme për protesta. Mund të presim një gjë të tillë në të ardhmen?

Gucati: Natyrisht se kemi menduar edhe për këtë çështje. Shumë shpejt do të ulemi me kryesinë dhe këshillin drejtues të OVLUÇK-së që të bisedojmë për hapat e më tutjeshëm. Nuk e përjashtojmë mundësinë e protestave, por për këtë çështje vendimi do të merret nga kryesia dhe këshilli drejtues i OVLUÇK-së.

"Epoka e re": A keni ndonjë mesazh për ata politikanë të cilët e kanë votuar këtë gjykatë?

Gucati: Mesazhi i OVLUÇK-së është se historia do të shkruhet dhe ajo do t'i dënojë të gjithë ata deputetë që kanë votuar për këtë gjykatë. Ata kanë bërë një gabim të rëndë kur e kanë votuar Gjykatën Speciale.

"Epoka e re": A besoni se tani ata i kanë rënë pishman?

Gucati: Është mirë t'i pyesni vetë ata, sepse unë me ta nuk dua as të kontaktoj.

Specialja fton edhe Smajl Latifin, Ibrahim Gashin dhe Jetullah Krasniqin

Smajl Latifi, Ibrahim Gashi dhe Jetullah Krasniqi janë tre të ftuarit e radhës nga Gjykata Speciale. Ata kanë bërë me dije se do t'u përgjigjen pozitivisht këtyre ftesave meqë besojnë në luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 TETOR - Gjykata Speciale të martën ka ftuar për intervistim edhe ish-rektorin e Universitetit të Prishtinës, Ibrahim Gashin. Ai ka thënë se do t'i përgjigjet pozitivisht kësaj ftese pasi është i bindur në luftën e drejtë dhe të pastër të UÇK-së. "Duke besuar në drejtësi, sikundër edhe duke qenë shumë i bindur në luftën e drejtë dhe të pastër të UÇK-së, do t'i përgjigjem pozitivisht kësaj ftese", ka thënë Gashi për medie.

Edhe ish-pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), aktualisht kryetar i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, është ftuar nga Gjykata Speciale. "Sot kam pranuar një ftesë për t'u paraqitur në Zyrën e Prokurorit të Specializuar me seli në Hagë. Kam qenë i vetëdijshëm se rrugë tjetër për çlirimim e popullit shqiptar, përveç luftës së armatosur, nuk ka. Zaten, kjo është mënyra e vetme për ta hequr robërinë popujt e pushtuar. I bindur në këtë pikëpamje, gjithnjë jam munduar të bëj më të mirën për vendin tim, pa i cenuar vlerat morale të kombit shqiptar, të dëshmuara në luftë dhe në paqe", ka shkruar Latifi në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se është i bindur se asnjë forcë në botë nuk do të arrijë ta përbaltë luftën e drejtë çlirimtare

sepse, sipas Latifit, mbi çdo skenar dashakeqës qëndron parimi i popujve për liri dhe të drejta kombëtare. "Prandaj, luftërat çlirimtare nuk mund të gjykoohen, sepse përmbajnë në vete parimin e shëndoshë të humanizmit dhe të drejtësisë. Parime këto të përfaqësuara dhe të përfaqësuara nga kombet e civilizuarat e të përparuarat të botës Perëndimore. Besoj në drejtësinë dhe asnjëherë nuk do të hezitoj të vihem në mbrojtje të së drejtës për liri e dinjitet njerëzor e kombëtar dhe jam gati të përballem me çfarëdo sfide. Mbetem i përkushtuar për sendërtimin e idealeve të kombit shqiptar dhe nga kjo rrugë nuk ka forcë që të më shkëpusë", ka shkruar më tutje Latifi.

Edhe ish-ushtari i UÇK-së, Jatullah Krasniqi nga Prizreni, ka bërë me dije se ka marrë ftesë për intervistim nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë. Në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka treguar se do t'i përgjigjet pozitivisht kësaj ftese, ndonëse këtë gjykatë e konsideron të njëanshme dhe të padrejtë. Sipas tij, nëse merret parasysh numri i madh i ftesave të kësaj gjykate për ish-pjesëtarët e UÇK-së, shihet qartë se është një tendencë e zbehjes dhe denigrimit të luftës së UÇK-së dhe sakrificës së popullit të Kosovës për liri. "Dua ta njoftoj opinionin, para së gjithash bashkëlloftëtarët e mi, se

këto ditë kam pranuar ftesë nga Zyra e Prokurorit të Dhomave të Specializuara për t'u paraqitur dhe për ta dhënë dëshminë time për periudhën e shërbimit në UÇK. Edhe pse e konsideroj si një gjykatë të njëanshme dhe njetnike, kam vendosur që kësaj ftese t'i përgjigjem pozitivisht sepse si sot ashtu edhe dje (para 20 vjetëve) nuk kemi asgjë për të fshehur, nuk kemi asgjë për t'u turpëruar. Është e tmerrshme që ne edhe pas 20 vjetësh vazhdojmë të përballemi me drejtësinë mbi bazën e akuzave të ngjarjeve të trilluara nga një Alfred Hickok i kohës moderne siç ishte Dick Marty. Ndërsa kriminelët të cilët vranë e masakruan mbi 10 mijë civilë shqiptarë, duke rrafshuar me tokë fshatra e qytete të tëra, vazhdojnë të shëtiten të lirë dhe të pashqetësuar. Duke marrë para sysh numrin e madh të ftesave që vazhdojnë të dërgohen për pjesëtarët e UÇK-së, shihet qartë se këtu nuk kemi të bëjmë me raste individuale, por është një tendencë e zbehjes dhe denigrimit të luftës së UÇK-së dhe sakrificës së popullit tonë për liri. Askush nuk do të guxoj ta cenojë lirinë tonë. Askush nuk do të mund të na sfidojë krenarinë që kemi për luftën e lavdishme të UÇK-së dhe dëshmorët e kombit. Lavdi luftës së UÇK-së! Lavdi dëshmoreve të kombit!", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".



ta mbrojnë veten dhe luftën e UÇK-së edhe këtë herë. Besoj dhe jam i bindur se të gjithë këta do të dalin faqebardhë. Kështu që, nuk do të kenë probleme me këtë drejtësi fare, sepse kjo gjykatë është një montim politik i ndërkombëtarëve dhe ne besojmë në pafajësinë e ish-ushtarëve të UÇK-së.

"Epoka e re": Përveç ftesave për ish-pjesëtarët e UÇK-së, kemi pasur disa raste që ftesa të tilla kanë marrë edhe individë që nuk kanë qenë pjesë e UÇK-së. Pse po ndodh kjo?

Gucati: Nuk kisha dashur të flas për ta sepse nuk jam i thirrur të komentoj në lidhje me individë të tjerë. Unë jam i thirrur të flas vetëm për veteranët e UÇK-së. Pra, për ata që nuk kanë qenë

Shpallet konkursi për rekrutimin e kadetëve të FSK-së për studime në ShBA

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ka shpallur konkurs për pranimin e kadetëve të FSK-së për studime në Akademinë e Forcave Ajrore dhe Akademinë Ushtarake-WEST POINT të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Studimet mbahen në gjuhën angleze dhe zgjasin katër vjet.

Është e dëshirueshme që kandidati të ketë të përfunduar testin TOEFL dhe testin SAT. Kandidatët do të nominohen nga Ministria e Mbrojtjes si kandidatë konkurrentë për studime. Kadetët pas përfundimit të shkollimit do të emërohen oficerë në FSK, në kohëzgjatje minimale të obligueshme, prej gjashtë vjetëve.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës pa dallim kombi, race dhe gjinie, të moshës 18-23 vjeç. Konkursi dhe formularët për aplikim janë në dispozicion në uebfaqen e Ministrisë së Mbrojtjes (mod.rks-gov.net). Konkursi është i hapur prej datës 22 tetor deri më 4 nëntor 2019.



Në këto qytete partitë dolën të parat

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Më 6 tetor Republika e Kosovës ka mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Sipas rezultateve preliminare, partia fituese e këtyre zgjedhjeve është Lëvizja Vetëvendosje (LV), pas saj radhitet Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe e treta Partia Demokratike e Kosovës (PDK), pas saj koalicioni AAK-PSD dhe koalicioni Nisma-AKR-PD që ende nuk e ka të sigurt nëse do ta kalojë pragun prej 5 përqindësh.

LV-ja ka dalë e para në nëntë komuna, LDK-ja në tetë komuna, PDK-ja në katër komuna, koalicioni AAK-PSD në pesë komuna, koalicioni Nisma-AKR-PD vetëm në një komunë. Ndërkaq Lista Srpska në dhjetë komuna.

Lëvizja Vetëvendosje ka dalë e para në Gjilan, Kaçanik,

Kamenicë, Obiliq, Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Hani i Elezit dhe Vushtrri.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka dalë e para në Dragash, Istog, Fushë-Kosovë, Lipjan, Pejë, Podujevë, Suharekë dhe Viti.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka dalë e para në Drenas, Mitrovicë e Jugut, Skenderaj dhe Shtime.

Koalicioni AAK-PSD ka dalë fitues në Deçan, Gjakovë, Klinë, Rahovec dhe Junik. Koalicioni Nisma-AKR-PD ka fituar vetëm në Malishevë.

Kosova Demokratikë Türk Partisi ka dalë fituese në Mamushë.

Ndërkaq Lista Srpska ka dalë e para në Leposaviq, Novoberdë, Shterpcë, Gracanica, Ranilluk, Partesh, Klllokot, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, dhe Zubin Potok.



Ndalohehen katër persona për fajde dhe detyrim

Gjatë kontrollit në cilësi të dëshmimeve janë gjetur dhe sekuestruar: Pesë vetura luksoze, 37,300.00 para kesh, 320 franga zvicerane, 12 telefona mobilë, 19 fishekë të kalibrit 7.62 mm. Numër i madh i dokumenteve të ndryshme si: kontrata të ndryshme mbi shitblerjen e pronave (shtëpi, banesa, lokale, vreshta dhe automjete).

PRIZREN, 22 TETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren, në bashkëpunim me Njësinë e Hetimeve kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren, ka zbatuar Urdhëresën e Gjykatës Themelore në Prizren për urdhër kontroll të shtëpive, lokaleve, automjeteve dhe pronës së personave të dyshuar për veprat penale "fajde" dhe "detyrim" në rajonin e Suharekës dhe gjatë bastisjes ka arrestuar të dyshuarit L. B., A. B., F. B. dhe F. Sh.

Gjatë kontrollit në cilësi të dëshmimeve janë gjetur dhe sekuestru-

ar: Pesë vetura luksoze, 37,300.00 para kesh, 320 franga zvicerane, 12 telefona mobilë, 19 fishekë të kalibrit 7.62 mm. Numër i madh i dokumenteve të ndryshme si: kontrata të ndryshme mbi shitblerjen e pronave (shtëpi, banesa, lokale, vreshta dhe automjete). "Katër personat e dyshuar janë intervistuar dhe me aktvendim të Prokurorit të Shtetit janë ndaluar për 48 orë, ndërsa po vazhdohej hetimet për të grumbulluar dëshmi relevante lidhur me rastin", është bërë me dije në njoftimin e Prokurorisë Themelore në Prizren.



KDI-ja dhe AKK-ja diskutojnë për bashkëpunimin në parandalimin e korrupsionit

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, është takuar të martën me drejtorin e Agjencisë Kundër

Korrupsionit (AKK), Shaip Havolli, për të diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë. "Sot në zyrat e

Agjencisë Kundër Korrupsionit u takuam me drejtorin z. Shaip Havolli për të diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, me

theks të veçantë për realizimin e aktiviteteve konkrete që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë", ka thënë Kryeziu pas takimit.



Migrimet ilegale, pengesë serioze për liberalizimin e vizave

Kosova aktualisht nuk është ende afër marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE, por pritjet e saj janë që BE-ja të marrë vendim pozitiv në lidhje me liberalizimin e vizave. Krahas problemeve me aspektet e sundimit të ligjit, një nga pengesat për Kosovën për heqjen e vizave ishte edhe numri i azilkërkuesve.

Por, bazuar në statistikat zyrtare, vërehet rënie e numrit të azilkërkuesve nga Kosova drejt shteteve të BE-së. Derisa në vitin 2015 numri i azilkërkuesve nga Kosova drejt vendeve të BE-së ishte shumë shqetësues, ky numër ka rënë dy vjetët e fundit, sipas statistikave të Eurostatit.



PRISHTINË, 22 TETOR - Liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës mund të komplikohet edhe më shumë, parashikojnë njohësit e integritimeve evropiane. Këto mëdyshje ata i mbështesin te qëndrimet mjaft të ngurta, siç thuhet, të Francës dhe disa vendeve të tjera në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor, që u reflektuan edhe me mungesën e konsensusit për nisjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Presidenti i Francës, Emanuel Macron, tha se çështja e numrit të madh të azilkërkuesve nga vendet e Ballkanit Perëndimor po ndikon që këto shtete po mbesin jashtë Bashkimit Evropian. Kosova aktualisht nuk është ende afër marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE, por pritjet e saj janë që BE-ja të marrë vendim pozitiv në lidhje me liberalizimin e vizave. Krahas problemeve me

aspektet e sundimit të ligjit, një nga pengesat për Kosovën për heqjen e vizave ishte edhe numri i azilkërkuesve.

Por, bazuar në statistikat zyrtare, vërehet rënie e numrit të azilkërkuesve nga Kosova drejt shteteve të BE-së. Derisa në vitin 2015 numri i azilkërkuesve nga Kosova drejt vendeve të BE-së ishte shumë shqetësues, ky numër ka rënë dy vjetët e fundit, sipas statistikave të Eurostatit. Sipas këtyre statistikave, gjatë vitit 2018 rreth 5 000 qytetarë të Kosovës kanë kërkuar azil në vendet e BE-së. Dy vjet më parë ky numër ishte dyfish më i madh.

Ligjëruesi i së Drejtës të Bashkimit Evropian, Artan Murati, tha për "Radion Evropa e Lirë" se ka një trend në rënie nëse krahasohet me vendet e tjera, madje përfshirë edhe Shqipërinë por, prapëseprapë, sipas tij, këto të dhëna për qyte-

tarët e Kosovës, të cilët kërkojnë azil në shtetet përkatëse, janë shqetësuese. "Si rrjedhojë konsiderohet se, nëse do të hapeshin kufijtë dhe do të krijoheshin mundësi, që këta qytetarë të lëvizin lirshëm në BE, atëherë kjo do të shndërrohej në një problem edhe më të madh. Por, liberalizimi i vizave do të mundësonte që edhe më mirë të ketë një mekanizëm nga shtetet e BE-së për të pasur në kontroll se kush hyn e del nga vendet e tyre dhe nuk besoj se do të krijonte ndonjë problematikë më të madhe sesa që ekziston tani", ka deklaruar Murati.

Kurse Përparim Kryeziu nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike tha për "Radion Evropa e Lirë" se nëse vendimi i BE-së, përkatësisht refuzimi i Francës sa i përket procesit të liberalizimit, është vendim mbi baza të vullnetit politik atëherë, sipas tij, cili është kuptimi i kriterëve

teknike të cilat Kosova është dashur t'i përmbushë. Sipas Kryeziut, një qasje e këtyllë e BE-së ndaj Kosovës dëmton ashpër besueshmërinë në të dhe rrezikon ta dobësojë rolin e saj si shtytëse e reformave për të cilat ka nevojë Kosova. "Numri i azilkërkuesve është një pretekst i cili po përdoret nga Franca për arsyetimin e pozicionit të saj. Migrim do të ketë si pa liberalizim të vizave, si me liberalizim të vizave. Migrimi është një formë e njohur e lëvizjes së njerëzve që nga ditët e para të shoqërisë sonë si njerëzim. Unë konsideroj se ky është vetëm një pretekst që po përdoret nga Franca për ta legjitimuar pozicionin e saj, që është kryekëput politik ndaj Ballkanit Perëndimor, e në këtë rast edhe për Kosovën", ka deklaruar Kryeziu.

Këshilli i ministrave i BE-së vitin e kaluar nuk e vuri fare në

agjendë çështjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Sivjet, sipas kryeministrit në detyrë, Ramush Haradinaj, pritjet janë që kjo çështje të mos lihet anash nga BE-ja.

Madje Haradinaj i kishte uruar qytetarët e Kosovës për, siç kishte thënë ai, liberalizimin e vizave, kurse BE-në e kishte siguruar se "Kosova nuk do të eksportojë azilkërkues, kriminelë apo pasiguri në Evropë, por qytetarë të ndershëm që duan të jenë të barabartë me qytetarët e tjerë evropianë".

Nga të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, përgjatë viteve 2013-2017 nga Kosova kanë emigruar më shumë se 170 mijë qytetarë. Numri më i madh i qytetarëve të cilët janë larguar nga vendi gjatë kësaj periudhe ishte viti 2015, kur nga Kosova emigruan mbi 75 mijë qytetarë, shumica prej tyre në formë të parregullt.

Kosova dhe Maqedonia e Veriut me Task-Forcë të përbashkët për sigurinë

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim të eliminimit të kërcënimeve të sigurisë, të martën kanë nënshkruar protokollin mbi themelimin e Task-Forcës së përbashkët.

Nënshkrimi i këtij protokollit është bërë nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj dhe drejtori i Policisë së Maqedonisë së Veriut, Sasho Tasevki. Ky protokoll u nënshkrua në kuadër të marrëveshjes mes të dy qeverive për bashkëpunim policor. Me këtë rast, ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka thënë se nënshkrimi i këtij pro-

tokollit në mes të dy vendeve është një vazhdimësi e bashkëpunimit shumë të mirë që Kosova dhe Maqedonia e kanë në fushën e sigurisë. "Kosova dhe Maqedonia kontribuojnë në ngritjen e sigurisë, me qëllim të krijimit të një ambienti më të sigurt për rajonin. Të dy vendet po bëhen model i bashkëpunimit, i cili duhet të zgjerohet tutje në rrafshin e bashkëpunimit rajonal edhe me shtetet e tjera", ka theksuar ministri Mustafa.

Task-Forca e përbashkët ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë në mes të dy vendeve për t'i eliminuar rreziqet e ndryshme për rendin dhe sigurinë publike, luftën kundër kriminit të organizuar, terrorizmit dhe krimeve tejkufitare.



Zgjerohet rrjeti i kanalizimit në Drenoc dhe Banjë

MALISHEVË, 22 TETOR (ER) - Në fshatrat Drenoc dhe Banjë të Malishevës janë duke vazhduar punimet për zgjerimin e rrjeteve të kanalizimit. Këto projekte janë duke u realizuar në kuadër të projekteve kapitale për vitin 2019, si dhe në kuadër të ndërtimit të infrastrukturës së përgjithshme, në veçanti të sistemit të rrjeteve të kanalizimit në vendbanimet e Komunës së Malishevës.

Punimet për zgjerimin e rrjeteve të kanalizimit në këta dy fshatra i kanë inspektuar nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, dhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Milazim Morina, të cilët janë njoftuar nga afër me punimet dhe realizimin e projekteve. "Zgjerimi i rrjeteve të kanalizimit është një prej obligimeve që kemi si komunë, në mënyrë që gradualisht jo vetëm të zgjerohen këto rrjete,

por të lidhen të gjitha së bashku në një vend dhe në fund të bëhet trajtimi i tyre", ka thënë Berisha. Sipas tij, nuk është i mjaftueshëm vetëm largimi i ujërave të zeza nga vendbanimi, por në planin afatgjatë edhe të trajtohen ato. Në fshatin Drenoc janë duke u ndërtuar dy kilometra rrjet i ri i kanalizimit, ndërsa në Banjë rreth 1 300 metra rrjet të cilat financohen nga buxheti i Komunës së Malishevës.



Haziri dhe ambasadori turk inaugurojnë projektin e renovimit të shkollës 'Musa Zajmi'

GJILAN, 22 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, dhe ambasadori i Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar, kanë inauguruar projektin e renovimit të klasave parashkollore në Shkollën Fillore "Musa Zajmi", të cilat janë bërë me donacion nga organizata shtetërore turke "Tika". Me këtë rast, Haziri ka falënderuar ambasadorin turk dhe Turqinë për mbështetjen e vazhdueshme. "E falënderoj ambasadorin Çagri Sakar për mbështetjen e tij dhe të shtetit turk ndaj Gjilanit në bujqësi dhe në arsim, sikurse edhe në ndërtimin e partneritetit që Gjilani e ka me Bursan tash e 10 vjet. Faleminderit Turqisë edhe për praninë ushtarake. Kjo mbështetje dhe solidaritet për renovimin e klasave parashkol-

lore do të thotë shumë sepse fëmijët nuk kanë dallime në etni. Ne i garantojmë mësim në gjuhët amtare dhe integrim të plotë në shoqëri, në institucione dhe në jetën publike në Gjilan", ka thënë Haziri.

Edhe drejtori i shkollës "Musa Zajmi", Ramadan Dermaku, ka falënderuar Turqinë për realizimin e këtij projekti. Ndërsa ambasadori i Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar, pasi e ka falënderuar kryetarin Haziri për mbështetjen për realizimin e këtij projekti, ka thënë se ky investim për renovimin e klasave parashkollore është i bindur se do të ndikojë te fëmijët që të marrin arsimim të mirë dhe cilësor. "Ky projekt është vulë e miqësisë historike mes popullit të Kosovës dhe atij të Turqisë. Në këtë shkollë fëmijët e



komunitetit shqiptar dhe komunitetit turk janë duke mësuar,

duke luajtur dhe duke u rritur së bashku. Do të vazhdojmë ta

mbështesim Kosovën edhe në të ardhmen", ka thënë ai.

Ekipet e ujësjellësit në aksion, kontrollojnë keqpërdorimet e mundshme



PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar konsumatorët në zonën e shërbimit Prishtinë, Fushë-Kosovë, Obiliq, Lipjan, Drenas, Podujevë, Shtime dhe Graçanicë, se duke filluar nga dita e martë ka nisur aksioni për t'i vëzhguar nga afër konsumatorët të cilëve u ofron shërbime për ujësjellës dhe kanalizim. Në një komunikatë për media të Ujësjellësit "Prishtina" bëhet me dije se qëllimi i këtij aksioni është verifikimi nëse konsumatorët po e keqpërdorin ujë-

matësit, identifikimi i kyçjeve ilegale si dhe verifikimi i objekteve të reja që e shfrytëzojnë ujin e pijshëm e që ende nuk janë regjistruar si konsumatorë të KRU "Prishtina" sh. a. "Kontrollime do të ketë në të gjitha zonat e operimit, e sot duke filluar nga fshati Llukar, rruga 'Bajram Bahtiri' në Prishtinë, duke vazhduar në lagjen Veternik, Hajvali etj., me ç'rast ditën e shtunë, më 26 tetor, ekipi kontrollues do t'i bashkëngjiten edhe ekipet e

shkqyes. Po fillojmë në zonat e lartcekura, duke vazhduar më pas edhe me zonat e tjera të shërbimit, gjithnjë duke u bazuar në të dhënat që kemi, që në këto zona po keqpërdoren ujëmatësit. Që të kemi një pasqyrë të saktë, kryesisht në evitimin e humbjeve të faturimit, shërbimi i shitjes në kuadër të KRU 'Prishtina' sh. a. përmes kontrollorëve në terren, do të veprojë deri në fund të vitit", është thënë njoftimin për media të të KRU "Prishtina" sh. a.

Nis rregullimi i rrugëve në pjesën e vjetër të qytetit të Gjakovës

GJAKOVË, 22 TETOR (ER) - Komuna e Gjakovës ka njoftuar se ka filluar faza e parë e rregullimit të rrugëve të pjesës së vjetër të qytetit. Kjo komunë ka theksuar se këto rrugë do të shtrohen me kubëza graniti. "Ditët plot diell të tetorit kanë dhënë hapësira për të punuar më me intensitet në projekte që lehtësojnë jetën e banorëve të

komunës sonë. E sot ka filluar faza e parë e rregullimit të rrugëve të pjesës së vjetër të qytetit e cila do të shtrohet me kubëza graniti. Ky projekt do të shtrihet nga shkolla 'Kelmend Rizvanolli' përgjatë rrugës 'Bajram Daklani', punimet e së cilës në tërësi do të zgjasin dy vjet e gjysmë dhe ka mundësi që kohë pas kohe të shkaktojnë

ngecje në trafik ose probleme të tjera infrastrukturore të cilat do të mund të ndodhin për shkak të ndërrimit të gypave të azbestit apo kanalizimeve", ka njoftuar Komuna e Gjakovës. Sipas kësaj komune, projekte të tilla mund të shkaktojnë pak kaos, mirëpo përfundimi i tyre është në dobi të banorëve për dekada të tjera.



Delegacioni i BQK-së përfundon pjesëmarrjen në takimet vjetore të FMN-së dhe BB-së

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 TETOR - Delegacioni i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga guvernatori Fehmi Mehmeti, ka përfunduar pjesëmarrjen në takimet vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore, të cilat u zhvilluan në Uashington të ShBA-së nga data 14-20 tetor 2019.

Në takimet vjetore delegacioni i BQK-së ka takuar përfaqësues të Thesarit Amerikan, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore dhe të institucioneve të tjera. Guvernatori Mehmeti takoi William C. Thomasin nga Thesari Amerikan, të cilin e informoi për zhvillimet e fundit në sektorin financiar dhe për treguesit e shëndetit financiar.

Guvernatori Mehmeti shprehu falënderimin dhe mirënjohjen për kontributin e madh që Thesari Amerikan ka dhënë për zhvillimin e kapaciteteve të BQK-së dhe për përkrahjen e vazhdueshme përmes asistencave teknike si dhe për zhvillimin e sektorit financiar të Kosovës.

Ndërkaq Thomas përgëzoi guvernatorin Mehmeti për të arriturat në sektorin financiar si dhe konfirmoi përkrahjen e mëtejme për BQK-në nga ana e Thesarit Amerikan. Në kuadër të këtyre takimeve, guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, është takuar edhe me zëvendës-drejtorin menaxhues të FMN-së, Tao Zhang, me të cilin kanë diskutuar për zhvillimet e fundit makroekonomike në Kosovë, me theks të veçantë qëndruesh-



mërinë dhe zhvillimet në sektorin financiar.

Me këtë rast, guvernatori Mehmeti ka falënderuar Fondin Monetar Ndërkombëtar për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës dhe BQK-së në veçanti, njëkohësisht e ka falënderuar Zhangun për gatishmërinë e FMN-së që të kontribuojë në Konferencën e 20-vjetorit të themelimit të BQK-së që do të mbahet në nëntor të këtij viti.

Guvernatori Mehmeti është takuar edhe me drejtorin e Departamentit Evropian të FMN-së, Poul Thomsen, me të cilin kanë diskutuar lidhur me zhvillimet e fundit makroekonomike, zhvillimet në sistemin financiar, si dhe për sfidat dhe objektivat strategjike dhe zhvillimore, përfshirë edhe bashkëpunimin e Kosovës me FMN-në.

Gjithashtu, guvernatori Mehmeti

është takuar edhe me ekipin e Misionit të FMN-së për Kosovë, i udhëhequr nga shefi i ri i Misionit, Gabriel Di Bella, me ç'rast e ka informuar lidhur me zhvillimet e fundit në sektorin financiar, përfshirë treguesit e shëndetit financiar.

Guvernatori Mehmeti falënderoi përfaqësuesit e FMN-së lidhur me raportin e Rishikimit të Stabilitetit të Sektorit Financiar (Financial Stability Sector Review) duke shprehur përkushtimin e BQK-së për zbatimin e rekomandimeve që dalin nga ky raport.

Guvernatori Mehmeti ka zhvilluar takime të ndara edhe me drejtorin e Konstituencës sonë në FMN, Raci Kaya, si dhe Paul Methieu nga Departamenti i Politikave Monetare dhe Tregjeve të Kapitalit të FMN-së, ku temë diskutimi ka qenë vlerësimi i FMN-së në kuadër të programit:

"Shqyrtimi i Stabilitetit të Sistemit Financiar" dhe rrjedhimisht ofrimi i Asistencës Teknike për BQK-në, përdorura në takimin me përfaqësuesin e Bankës Botërore, Mario Guadamillas, janë diskutuar asistencat teknike për Sistemin e Pagesave dhe Hendekut Financiar, si dhe projekte të tjera zhvillimore të BQK-së".

Në takimet e zhvilluara me zëvendëspresidentin e Bankës Botërore, Cyril Muller dhe me drejtoreshën e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, Linda Van Gelder, temë diskutimi kanë qenë zhvillimet e fundit makroekonomike në Kosovë, politika zhvillimore e kredive (Development Policy Loan DPL), si dhe projektet në proces që kanë të bëjnë me vlerësimin e Sistemit të Pagesave dhe hendekut financiar.

Guvernatori Mehmeti ka falënderuar Bankën Botërore për

mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë BQK-së në zhvillimin e shumë projekteve me rëndësi për sistemin financiar në Kosovë. Në të njëjtën kohë, guvernatori Mehmeti ka informuar Mullerin lidhur me zhvillimet e fundit në sektorin financiar si dhe e ka falënderuar për gatishmërinë e Bankës Botërore që ta japë kontributin e saj në konferencën e 20-vjetorit të themelimit të BQK-së që do të mbahet në nëntor të këtij viti.

Delegacioni i BQK-së i kryesuar nga guvernatori Mehmeti është takuar edhe me drejtorin e Konstituencës sonë në Bankën Botërore, Guenther Schoenleitner, si dhe ka marrë pjesë në takimet e ndara të Konstituencës së Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, pjesë e të cilave është edhe Kosova. Gjithashtu, gjatë ditës së fundit përfaqësuesit e BQK-së kanë marrë pjesë në mbledhjet plenare të Komitetit Ndërkombëtar Monetar dhe Financiar të FMN-së, si dhe në diskutimin e guvernatorëve dhe ministrave të Evropës Qendrore dhe Lindore lidhur me parashikimet ekonomike të FMN-së për rajonin.

Takimet vjetore të Bordit të Guvernatorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Grupit të Bankës Botërore bashkojnë bankierët e bankave qendrore, ministrat e financave, drejtuesit e sektorit privat, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe akademikëve për t'i diskutuar çështjet e financave të fokusuara në ekonominë globale, zhvillimin ndërkombëtar dhe ato të sistemit financiar botëror.

INDEP-i kërkon nga qeveria e ardhshme ta shkëpusë kontratën për termocentralin 'Kosova e Re'

Prishtinë, 22 tetor - Me rastin e Ditës Botërore të Energjisë, Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP ka shpalosur prioritetet që, sipas tyre, duhet t'i ketë qeverisja e re në sektorin e energjisë. Me këtë rast është kërkuar që qeveria e ardhshme ta ndërpresë kontratën për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re".

Përfaqësuesja e INDEP-it, Learta Hollaj, duke folur për rëndësinë e tranzicionit të energjisë paraqiti nevojën për dekarbonizimin e energjisë. Teksa ka kërkuar edhe ndryshim të legjislacionit aktual për t'ia lehtësuar investimet në sektorin e energjisë. "Tranzicioni i energjisë ka qëllim largimin e lëndëve fosile. Masa e parë që duhet të marrë qeveria e re është ndërprerja e kontratës për termocentralin 'Kosova e Re'. Mënyra si e shohim më tutje zhvillimin e energjisë është në mënyrë të integruar, si hap përtej së ndërprerjes së kontratës së Kosovës së Re,

duhet të fokusohemi tek masat e efëciente të energjisë. Në aspektin e efëciencës së energjisë duhet të fokusohemi të humbjet në rrjetin elektrik. Hap tjetër është bashkëpunimi rajonal, të rrjetit i interkisionit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë dhe liberalizimi i tregut të energjisë", ka deklaruar ajo.

Ndërkaq hulumtuesi Dardan Abazi ka folur për prioritetet që duhet t'i ketë qeverisja e ardhshme. "Ne konsiderojmë se ndërprerja e kësaj kontrate është mundësia për t'i hapur tregut të energjisë sepse me këtë nuk ka as liberalizim të tregut. Koha e centraleve të mëdha ka kaluar, është koha të kemi një qasje të decentralizimit të energjisë. Kur jemi te kjo sfida e dytë për neve është përkushtimi i qeverisë së ardhshme për një tranzicion energjik për ta dekarbonizuar energjinë. Investimet në efëciencë do të kërkojnë fuqi punëtore dhe zhvillim ekonomik", ka thënë Abazi.



Basrie Murati-Sakiri merr pjesë në Festivalin e Librit dhe Letërsisë në Zurich

Lulëzim ETEMAJ

Nga data 23-27 tetor 2019 mbahet në Zurich të Zvicrës Festivali i Librit dhe Letërsisë, "Zurich liest" ("Cyrihu lexon"). Ky festival është themeluar në vitin 2009 nga librarët dhe Shoqata e Botuesve e Zurichut, mbahet çdo vit dhe është festivali më i madh i letërsisë dhe librit në Zvicër.

Pjesë e programit pesëditor të larmishëm dhe shumë të pasur të këtij festivali, krahas shkrimtarëve të nominuar për Çmimin "SCHWEIZER BUCH PREIS 2019", si Alain Claude Sulzer dhe Ivna Zhiç, si e ftuar speciale është edhe shkrimtarja shqiptare nga Kosova me banim në Zvicër, Basrie Murati-Sakiri. "Unhaltbare Zustände" ("Rrethana të papërbalueshme"), ky është titulli i romanit të shkrimtarit zviceran Alain Claude Sulzer, i cili para

publikut do të paraqitet më datën 25 tetor 2019, duke filluar nga ora 20.00-21.30. Shkrimtarja kroate, Inva Zhiç, e lindur në Zagreb dhe rritur në Zurich, romani i së cilës mban titullin "DIE NACHKOMMENDE" ("Pasardhësi"), është në program për t'u lexuar për publikun më 26 tetor 2019, nga ora 19.30-21.00.

"Në mënyrë mbresëlënëse e përshkruan Basrie Murati-Sakiri në ditarin e saj dypjesësh se si është ta lësh prapa gjithë jetën tënde. Së bashku me vëllezërit e saj, shoqet dhe shokët, si 18-vjeçare, ajo luftonte për Kosovën Republikë. Kryengritja e tillë e detyroi atë të arratiset në vitin 1989 në Zvicër". Kjo është një pjesë e shkëputur nga prezantimi që i bëhet librit të autores shqiptare Basrie Murati-Sakiri, "Bleibende Spuren - Mein Weg vom Kosovo in die Schweiz" ("Gjurmë të përhershme, rruga

ime nga Kosova në Zvicër"), të botuar më 30 prill 2019 nga njëra prej shtëpive botuese më prestigjioze në Zvicër, "Rotpunktverlag", në faqen zyrtare të internetit të Festivalit "Zurich liest".

Sipas programit të festivalit, Basrie Murati-Sakiri do të lexojë pjesë të librit të vet për publikun e pranishëm ditën e diel, 27 tetor 2019, nga ora 17.00-18.00. Autorja e librit është veprimtarja e dalluar kombëtare, ish-pjesëtare e "Çetës së Llapit", e njohur si "Shqipja". Libri i saj është duke bërë jehonë të madhe si te mediat e shumta zvicerane, po ashtu edhe te publiku, i cili që nga fillimi ka shprehur një interesim të shtuar për të, qoftë përmes pjesëmarrjes në prezantime, duke filluar nga prezantimi i parë, i mbajtur më 6 qershor në "MAXIM Theater", në prezantimin që i është bërë nga Andrea Jost, krijuese teatri dhe moderatore në Radiotelevizionin e Zvicrës, SRF, në kuadër të Javës së Kulturës, "Rendez vous Balkan", më 21 shtator 2019 në Bibliotekën e Effretikonit, atë të mbajtur në Bern, më 18 tetor 2019, apo forma të tjera.

Interesim të posaçëm për librin "Bleibende Spuren - Mein Weg vom Kosovo in die Schweiz" kanë treguar edhe bibliotekat e shumta të cilat kanë siguruar ekzemplarë të librit për lexuesit e tyre.

Prezantimi i radhës i këtij libri, gjithsesi i veçantë për faktin se organizohet nga studentët shqiptarë, të organizuar në shoqatën e tyre "Studenti", me seli në Zurich, do të mbahet

Basrie Sakiri-Murati: «Bleibende Spuren - Mein Weg vom Kosovo in die Schweiz»




27.10. Zürich liest - Sofa-Special

ditën e enjte, 31 tetor 2019, në Universitetin e Zurichut, Rämistrasse 71, 8006 Zürich, nga ora 18.30-21.00.

Të interesuarit librin "Bleibende Spuren" mund ta gjejnë ose porosisin në të gjitha libraritë, si në Zvicër ashtu edhe

në Austri e Gjermani. Porosia mund të bëhet po ashtu edhe online, direkt te Shtëpia Botuese "Rotpunktverlag" apo në libraritë e mëdha që kanë faqe interneti dhe e ofrojnë një shërbim të tillë për klientët e tyre.



Miratohen politikat e trajnimeve për prokurorë dhe stafin administrativ për vitin 2020

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka miratuar të martën politikat e trajnimit për prokurorët dhe stafin administrativ të sistemit prokurorial për vitin 2020, të cilat do ta përshtaten me planin e punës së Akademisë së Drejtësisë dhe bazohen në kompetencat ndërsektoriale, si dhe janë harmonizuar me dokumentet strategjike, duke i kushtuar vëmendje të veçantë metodologjisë së luftimit të krimit

financiar, korrupsionit dhe krimeve të luftës. Gjatë këtij takimi të udhëhequr nga kryesuesi Bahri Hyseni, pas hedhjes së shortit, Këshilli Prokurorial ka miratuar formimin e dy paneleve hetimore për shqyrtimin e rasteve disiplinore në Prokurorinë Themelore në Gjilan. Nga ana tjetër, në kuadër të raportimeve të rregullta të kryesuesve të komisioneve të përhershme për aktivitetet e tyre për nëntëmuorin e këtij viti, Këshillit i raportu-

an kryesuesi i Komisionit për Çështje Normative, Zejnullah Gashi, kryesuesja e Komisionit për Vlerësimin e Prokurorëve, Ikramije Bojaxhiu, kryesuesja e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel, Dëshirë Jusaj dhe Kryesuesja e Komisionit për Administrimin e Prokurorive, Radica Miliq. Në fund të takimit është miratuar edhe raporti i Komisionit për Vlerësim të Performancës së Prokurorëve.



Studentët e Juridikut në AAB do ta kryejnë praktikën në gjykatat themelore dhe në Gjykatën e Apelit të Kosovës



PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Fakulteti Juridik i Kolegjit AAB fillimin e vitit akademik 2019/20 e ka nisur me zgjerimin e listës së partnerëve dhe bashkëpunëtorëve akademikë e profesionalë. Ky fakultet ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Një marrëveshje e tillë ka për qëllim krijimin e kushteve për kryerjen e punës praktike të studentëve që janë pjesë e këtij fakulteti. Ky

bashkëpunim u nënshkrua nga dekani i Fakultetit Juridik në Kolegjin AAB, prof. ass. dr. Veton Vula dhe kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Skender Çoçaj. Studentët do të kenë mundësi të kryerjes së punës praktike në gjykatat themelore në Kosovë dhe atë të Apelit. Secili bashkëpunim i Kolegjit AAB ka për qëllim avancimin profesional të studentëve në fushat të cilat studiojnë dhe që janë pjesë e jona.

Konspiracionet e vjetra, si gogol për një konfiguracion tjetër politik në Kosovës



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Ndershmëria e votimit dhe hajnia e numërimit: Procesi i votimit dhe organizimit të zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 u zhvillua dhe përfundoi në përputhje me standardet demokratike që nënkupton se ky proces ishte i ndershem për dallim të herëve të tjera. Te të gjitha zgjedhjet e mëparshme sikur edhe tani, procesi i votimit ishte vetëm pjesa e parë e lojës e që nuk ndikonte në rezultatin përfundimtar, për faktin se loja vazhdonte edhe në pjesën e dytë, sidomos gjatë numërimit të votave, ku edhe trukohen rezultatet. Aty vendoset se kush do të jetë pjesë e listës kualifikuese për Kuvend të Kosovës, pavarësisht nëse i ka fituar votat e mjaftueshme apo jo. Edhe kësaj radhe dolën se jo votuesit, por komisionarët e zgjedhjeve votojnë për deputetë dhe se vota e tyre është votë përcaktuese, vlen më shumë se votat e qindra e mijëra votuesve. Kjo luftë e komisionarëve thuaja është legale dhe është një mirëkuptim midis tyre pavarësisht cilës parti i takojnë. Partitë, përmes komisionarëve kujdesen t'i mbrojnë votat e tyre nga partitë e tjera, por nuk iu intereson se çka bëjnë komisionarët me votat e partisë që i takojnë. Është një hajni brenda llojit dhe është një marrëveshje "xhentëlmënësh" ku nuk kanë interesim për partitë e tjera në rast se nuk hyjnë në "terren të huaj". Të gjithë që kanë njohuri, madje edhe elementare për zgjedhje, e kanë të qartë se komisionarët janë "bossa" dhe "votues" që vendosin, sipas urdhrit ekzekutiv të kryetarit apo ndonjë grupi të interesit se kush do të bëhet deputetë e kush nuk do të bëhet. Besoni se disa komisionarë manipulimin me vota, e që shqip përktehet si hajni, e kanë ngritur në nivelin e perfeksionimit dhe bëjnë lëvizje sikur që magjistarët para publikut në ndonjë cirk, prandaj edhe prania e prokurorisë dhe policisë nuk është ndonjë kërcënim serioz për ta! Realisht, çdo parti ka komisionarë fanatikë që veprojnë sipas bindjes, por edhe sipas interesit material dhe për këtë marrin një rrezik duke u arrestuar dhe dënuar me burg. Është një përçmendje e kalkuluar e komisionarëve që shërbejnë si "kokë turku" duke u sakrifikuar për partinë por që partia, në rastin e parë distancohet nga ata në mënyrë që të rekrutojë komisionarë të "ndershem", për zgjedhjet e radhës. Pavarësisht kësaj, e kemi një rezultat të zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 që e nxjerrë fitues LV-në, të dytën LDK-në, PDK-ja është partia e tretë, kurse AAK-ja del të jetë e katërta. Nisma, e martuar në mënyrë jonormale me AKR-në dhe PD-në është duke

bërë përpjekje ta kalojë pragun e që, nëse vazhdon ky trend, e ka të vështirë ta kalojë këtë prag. Po të shkonte Nisma e vetme në zgjedhje, jam i sigurt se do ta kalonte pragun pa asnjë problem. Kështu, duke u mundur ta shpëtojë një të mbytur në skenën politike kosovare - AKR-në dhe një tjetër të stërmbytur, PD-në, duket se do të fundosen, së bashku, si Romeo dhe Xhuljeta. Nuk mund ta paramendoj Kuvendin e Kosovës pa Bilal Sherfin, Valdeten dhe idolin tim kombëtar dhe politik, Zafir Berishën. Për Kosovën do të ishte një tragjedi kombëtare, politike dhe shtetërore nëse në këtë Kuvend mungojnë Behgjet Pacolli dhe Fatmir Matoshi. Merreni edhe 1 të PD-së dhe koalicioni bëhet pjesë e Kuvendit. LDK-ja e do Nismën në Kuvend për ta mbajtur si gogol ndaj LV-së, kurse LV-ja nuk do ta pranonte këtë koalicion (pjesë e PAN-it) sepse këto ishin zotime publike; nuk ka koalicion me PAN-in. Albin Kurti, si kryeministër i ardhshëm i Kosovës, në bazë të votave të fituara, edhe nëse koalicioni Nisma-AKR-PD nuk do të kalonte pragun, duke vlerësuar kontributin e jashtëzakonshëm të Behgjet Pacollit në planin njerëzor, kombëtar, politik dhe shtetëror dhe i cili, tërë jetën dhe tërë kapitalin (shumëfish më të madh se Hasan Prishtina dikur) e vuri në shërbim të interesave kombëtare, politike dhe për bashkim kombëtar, Pacollin do ta mbajë afër vetes qoftë si ministër për Punë të Jashtme ku ka treguar shkëlqimin brilante sikur edhe do ta emërojë zëvendëskryeministër i parë sepse Begja kurrë nuk ka qenë i dyti. Pra, pavarësisht pragut, Behgjet Pacolli, si vlerë e shtuar kombëtare, politike dhe shtetërore, së bashku me Agim Bahtirin do të jenë krahë të Albin Kurtit dhe, Albini, pa ta, kurrë nuk do të ketë mundësi të fluturojë drejt majave.

Situata pas zgjedhjeve: Asnjëherë nuk kemi pasur një gjendje më të qartë pas zgjedhjeve; LDK-ja dhe LV-ja janë deklaruar për ta formuar një koalicion qeverisës, kurse AAK-ja dhe PDK-ja janë deklaruar se do të jenë një opozitë konstruktive. Ramush Haradinaj nuk i beson Albinit, madje e quan edhe mashtrues e që nënkupton se nuk mund të kenë koalicion. Kadri Veseli është treguar më i kujdesshëm ndaj Albinit, nuk e fyen, por as nuk pranon, siç thotë Kadri Veseli, nëse i shpëton "bisedës informative" me Sami Lushtakun, të bëhet pjesë e qeverisë. Nuk shoh asnjë pengesë nga ana e opozitës së ardhshme që do ta vononte zyrtarizimin e koalicionit qeverisës LV dhe LDK përveç deklaratave dhe kushtëzimeve të papeshuara të zyrtarëve partiakë të dy subjekteve politike që aspak nuk duhen, por se i bashkon interesi, më herët për ta dërguar PDK-në në opozitë e që e arritën e tash bëhet fjalë për puro interes pushteti. Jam i bindur se së paku 90 për qind të anëtarësisë së LDK-së, por edhe

udhëheqjes politike, bashkëqeverisjen me LV, në krye me El Comadante - Albin Kurtin e marrin si një dënim, por se "zori" - pushteti është çelës për të gjitha arsyetimet. Si popull që jemi të prirë për konspiracion, që lindim dhe rritemi me këtë ndjenjë, kohët e fundit qarkullonte një përfolje se Nisma po hyn në Kuvend me qëllim që të bashkohet me PDK-në, AAK-në dhe serbët e Vuçiq Rakiqit dhe pakicat e tjera, për t'i lënë në opozitë LV-në dhe LDK-në. Pastaj, LDK-ja si e dëshiruar nga të gjithë dhe për shkak të brishtësisë së rezistencës, si parti "shtetndërtuese", do t'u bashkohej partive të tjera dhe LV-ja do të ngele në opozitë, kurse kryeministër do të ishte Vjosa Osmani e jo Albin Kurti apo, siç e quan kritiku i mirënjohur i filmimit dhe artit në përmasa ndërkombëtare, Lutfi Haziri, "Mr. Bean". Teoritikisht kjo matematikë është e mundshme, moralisht dhe njerëzisht do të ishte e neveritshme dhe do të duhej të kundërshtohet nga të gjithë, pavarësisht cilit subjekt politik i takojnë. Nuk besoj se Kadri Veseli dhe Ramush Haradinaj do të bëheshin pjesë e kësaj loje të ndyrë, në të kundërtën ky do të ishte fundi i karrierës së tyre politike dhe jo vetëm politike. Votuesi ka dhënë mendimin, vlerësimin dhe përkushtimin për një mënyrë tjetër të qeverisjes dhe kjo duhet të respektohet nga të gjithë, deri në një situatë tjetër. Realisht, LV-ja dhe LDK-ja po e marrin qeverisjen në kohën më të keqe dhe më të vështirë për ta, kurse PDK-ja dhe AAK-ja, ndoshta edhe Nisma, po lirohen nga përgjegjësitë në kohën më të mirë për këto parti. Premtimet për ndryshime nga fituesit e zgjedhjeve janë shumë të mëdha sikur edhe pritjet e qytetarëve dhe të votuesve. Nëse koalicioni fitues punon mirë, duhet të përkraket nga të gjithë dhe duhet të ndihmohet gjithashtu nga të gjithë. Është shumë më lehtë të rrënosh se të ndërtohet! Opozita duhet të jetë bashkëpunuese për të gjitha çështjet që përbëjnë interes shtetëror sikur që pozita duhet të jetë e kujdesshme me opozitën, në të kundërtën do ta kemi një situatë sikur në Shqipëri! Për herë të parë në Kosovë, pas përfundimit të luftës kemi një opozitë që deklarohet se me asnjë çmim nuk pranon të jetë pjesë e pushtetit. Kadri Veseli i pranoi rezultatet e zgjedhjeve ashtu edhe Ramush Haradinaj e që më parë ka qenë e paimagjinueshme. Ramush Haradinaj po tregohet i matur, kurse Kadri Veseli, nëse shpëton nga Sami Lushtaku, ka punë me reformimin e partisë. Po shpresoj se në çastin e fundit Samiu do t'i kthehet shkencës së historisë, ku si historian mund të kontribuojë shumë më tepër dhe se politikën do ta bëjë si rekreacion, diçka fakultative, për ruajtje të kondicionit intelektual.

Albin Kurti si kryeministër: Albini po sillet sikur kryeministër duke

përdorur një fjalor tipik të një opozitari. Ende po deklarohet sikur gjatë fushatës zgjedhore. Albin Kurti po bëhet kryeministër sipas parimeve të Çerçillit; shumë punë, mund, djersë dhe gjak. Rrugën drejt zyrës së kryeministrit e ka kaluar duke u tërhequr zvarrë rrugëve nga policët e UNMIK-ut, EULESH-it, një pjesë të Policisë së Kosovës, me arreste shtëpiake dhe burgje të vazhdueshme, duke u keqtrajtuar me gaz lotsjellës, por edhe fizikisht sikur edhe duke u gjykuar dhe dënuar nga gjykatat ndërkombëtare dhe vendore. Hiç këtu kalvarin që e kaloi në burgjet e Serbisë së Millosheviqit, Sheshelit dhe Aleksandar Vuçiqit. LV-ja e shndërroi në aparat të përsosur ku butonin për vendimmarrje përfundimtare kishte të drejtë ta shtypte vetëm ai dhe askush tjetër. E ndërtoi një autoritet që nuk sfi dohej nga racionalistët, kurse kur aventurierët e sfiduan këtë autoritet, nuk fituan vota as për kuvendet të lagjeve ku jetojnë e lere më për Kuvend të Kosovës. Albin Kurti po jep intervista edhe kur flenë dhe u bë adresë e vizitave edhe të atyre që dikur e anatemonin dhe se nuk pranonin ta takonin kurrë. Tash po e testojnë Albinit se çfarë kursi do të mbajë për bisedime me Serbinë. Ndërkombëtarëve nuk iu intereson, në këto çaste, as lufta kundër korrupsionit dhe kriminit të organizuar dhe dukuritë e tjera negative me të cilat edhe vetë kanë bashkëjetuar dhe, në disa raste kanë kontribuar në trashjen dhe lulëzimin e këtyre aktiviteteve kriminale. Ndërkombëtarëve iu intereson vetëm vazhdimi i dialogut me Serbinë, heqja e taksës 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja sikur edhe gjetja e një zgjidhjeje kompromisi ku, edhe ndryshimi i kufijve do të mirëpritej nëse do të merreshin vesh Serbia dhe Kosova, ndërkaq që kjo marrëveshje do të imponohej dhe kushtëzohej me investime materiale si dhe procese integruese. BE-ja është një mashtruese shumë e madhe; e mashtroi Kosovën për demarkacion të kufirit me Malin e Zi me dhënien e vizave. Ende jemi në geto dhe të burgosur nga Evropa, ndonëse thanë se i kemi plotësuar të gjitha kushtet e para. Po të mos ishte taksa 100 për qind, sot do ta kishim një Kosovë ndryshe, me më pak terror dhe me një Zajdnicë të Serbisë në Kosovë. E mashtruan Shqipërinë se do të fillonin bisedimet për anëtarësim në BE nëse e bën vetëgjykim në drejtësi. Tash po thonë se Shqipëria është vend i kanabisit në kohën kur vaji i kanabisit është legalizuar në disa shtete evropiane. Kolumbia e Pablo Eskobarit është vendi ku prodhohet më së shumti kokainë në botë, ka fituar liberalizimin e vizave dhe te shtetet e BE-së qëndron më mirë se Shqipëria. Maqedoninë e Veriut e mbajtën peng 9 vjet me radhë për shkak të emrit dhe kur arriti marrëveshjen me Greqinë për një emër pa identitet shtetëror apo emër që është

zgjatje e emërimit të Maqedonisë në Greqi, BE-ja ia tregoi bërrylin apo gishtin e mesëm. Serbia që nuk e bëri asnjë lëshim të vetëm përballë shteteve të BE-së dhe që mbeti destabilizuesja dhe kërcënuesja kryesore kundër paqes në Ballkan i fitoi të gjitha përfitimet e mundshme nga BE-ja. Albin Kurti po mban qëndrim të fortë për bisedimet me Serbinë dhe në këtë drejtim duhet të përkraket. Së paku, deri më tani po tregohet i palëkundur sa i përket integritetit territorial të Kosovës, shtrirjes së sovranitetit brenda këtij integriteti territorial, të trajtohet dhe respektohet si palë e barabartë në këto bisedime dhe se nuk është me rëndësi shpejtësia e arritjes së marrëveshjes sa është përcaktuese përmbajtja e kësaj marrëveshjeje. Është qëndrim i drejtë dhe rikthim i një dinjiteti të humbur dhe të nëpërkëmbur. Ka marrë një qëndrim të duhur përballë Listës Serbe e cila tani po deklaron se nuk mund Albin Kurti ta shkelë Kushtetutën e Kosovës që iu garanton të drejta LS-së, në ndërkohë që vetë kjo listë shoviniste kurrë nuk e ka respektuar Kushtetutën e Kosovës e as Kosovën si shtet, ndërkaq që Aleksandar Vuçiqin e konsiderojnë president të tyre. Kjo ndarje dhe përballje është lehtësisht e kalueshme; mjafton që Lista Serbe ta respektojë Kushtetutën e Kosovës dhe të sillet në përputhje me ligjet e vendit dhe Albin Kurti, si përfaqësues dhe mbrojtës i Kushtetutës së Kosovës, i normalizon raportet me LS-në, në përputhje me detyrimet që i ka si kryeministër i të gjithë qytetarëve të Kosovës. Aleksandar Vuçiqi dhe politikanët e tjerë të Serbisë po e cilësojnë Albin Kurtin si ekstremist me të cilin qenka e pamundur të bisedohet duke e bërë edhe partner të padëshirueshëm për shtetet perëndimore që duan një paqe midis Kosovës dhe Serbisë, pavarësisht se sa do ta dëmtojnë Kosovën. Nuk e besoj kurrë se Albin Kurti do ta dëmtojë Kosovën, prandaj bisedimet me Serbinë, ose do ta ngritin Albinit në piedestalin e vlerave më të ndritura kombëtare ose, në të kundërtën, politikisht do ta varrosin! Në këtë rrugëtim drejt qëllimit të përbashkët dhe interesit që do ta mbronte çdo vend normal në botë, Albin Kurti nuk duhet të jetë i vetmuar apo t'i vihen ndërskamka. Problemi midis Kosovës dhe Serbisë është lehtësisht i zgjidhshëm brenda kufijve ekzistues, kurrsesi brenda do kufijve që i patën projektuar Vuçiqi, Mogerini, Rama dhe Shima. Serbia i ka bërë aq shumë të këqija dhe dëme Kosovës për të lejuar të vazhdojë ende me këtë aktivitet kriminal. Tash, pasi Albin Kurti të bëhet kryeministër, do të hetojmë nëse atë që e ka thënë gjatë fushatës dhe që po e thotë edhe sot është një rezultat i shkathtësive retorike apo vërtet e ka përnjëmend. Tymi shpejt do të shpërndahet dhe do të kemi një pamje më të qartë sa i përket ardhmërisë së Kosovës!

Justin Trudeau fiton zgjedhjet në Kanada

OTAVA, 22 TETOR - Partia e kryeministrit kanadez Justin Trudeau doli fituese e zgjedhjeve të hënën, por mazhoranca e tij u reduktua me 21 vende krahasuar me mandatin pararendës. Liberalët e partisë së Justin Trudeau fituan vetëm 157 vende, ose 13 më pak se pragu i nevojshëm prej 170 vendesh për të qeverisur të vetëm. Trudeau do t'i duhet të formojë një koalicion qeverisës me

Demokratët e Rinj Progresistë, të cilët fituan 24 vende në parlament.

Në një fjalim përpara mbështetësve të tij teksa shpalli fitoren, Trudeau tha se me votën e tyre kanadezët refuzuan ndarjen dhe të keqen. Trudeau nuk e përmendi humbjen e shumicës, por u tha mbështetësve të tij se progresistët fituan "një mandat të qartë" për të zbatuar agjendën e tyre dhe për më

shumë veprime për të luftuar ngrohjen globale.

Zgjedhjet ishin një zhgënjim për Andrew Scheer, udhëheqësin e Konservatorëve në opozitë, i cili u përpoq për të fituar shumicën. Edhe pse Konservatorët fituan votën popullore, ata arritën të marrin 121 vende. Scheer tha se ai do të vazhdojë të udhëheqë partinë, por rezultati duket se do t'i rihapë diskutimet mbi të ardhmen e tij.



Putini dhe Erdogani bisedojnë për situatën në Siri

Presidenti rus Vladimir Putin dhe homologu i tij turk, Rexhep Tajip Erdogan, u takuan në qytetën bregdetare Soçi për të diskutuar mbi operacionet turke në Sirinë Verilindore dhe për planet e Turqisë në të ardhmen e afërt

MOSKË, 22 TETOR - Presidenti rus Vladimir Putin dhe homologu i tij turk Rexhep Tajip Erdogan shprehën optimizëm se me diskutimet mes tyre do të arrijnë t'i zgjidhin "çështjet e komplikuar të rajonit". Dy udhëheqësit u takuan në qytetën bregdetare Soçi për të diskutuar mbi operacionet turke në Sirinë Verilindore dhe për planet e Turqisë në të ardhmen e afërt. Presidenti turk mbërriti në Soçi në brigjet e Detit të Zi për takimin me udhëheqësin rus mbi situatën kritike në Sirinë Verilindore, ka njoftuar voa. Pasi e përshëndeti homologun turk, presidenti rus nënvizoi marrëd-

hëniet e mira mes dy vendeve si armë diplomatike në trajtimin e kësaj situatë. "Dua ta përcjell shpresën se marrëdhëniet rusoturke, në nivelet që kanë arritur kohët e fundit, do të luajnë rol për t'i zgjidhur të gjitha çështjet e komplikuar në rajon", tha presidenti Putin.

Nga ana e tij, presidenti turk Erdogan u përqendrua tek objektiva e Turqisë për të arritur synimet e operacionit. "Besoj se takimi ynë do të ofrojë mundësi reale për mbarëvajtjen e operacionit në Siri", tha presidenti turk.

Para takimit, zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, kishte



shprehur synimet e presidentit rus për të kërkuar në bisedimet me Erdoganin më shumë informacion për planet turke në rajon. Turqia është betuar ta vazhdojë ofensivën kundër luftëtarëve kurdë.

Zëdhënësi Peskov tha se Turqia duhet të marrë leje nga qeveria siriane për t'i dislokuar forcat në territorin sirian, duke sinjalizuar se Moskë shpreson që të ketë

bisedime mes Turqisë dhe Sirisë lidhur me ndërhyrjen turke në Sirinë Verilindore.

Turqia dërgoi trupa në Sirinë Verilindore disa ditë më parë në një ofensivë për t'i luftuar forcat rebele kurde, pas vendimit të Shteteve të Bashkuara për t'i tërhequr trupat nga rajoni.

Vendimi është kritikuar nga ligjvënës nga të dyja partitë politike si dhe nga analistë, të cilët

paralajmërojnë se tërheqja amerikane do të krijojë një vakum që do të shfrytëzohet nga fuqi të tjera si Rusia.

Analistët thonë se takimi Putin-Erdogan do të sinjalizojë nëse Rusia është e gatshme t'i lejojë Turqisë dorë të lirë në rajon. "Jam i interesuar të shoh nga ky takim nëse presidenti Putin do të përpiqet ta frenojë Erdoganin dhe Turqinë në një fare mënyre", thotë analisti Brian Katulis.

Qindra luftëtarë kurdë mbeten në rajon, me gjithë marrëveshjen e armëpushimit të arritur me ndërmjetësimin amerikan që parashikon tërheqjen e tyre, tha presidenti turk para nisjes për në Soçi. Turqia mund të rifillojë ofensivën sapo të skadojë afati, shtoi ai. Armëpushimi pesë ditësh ka përfunduar të martën në orën 19 sipas orës lokale.

Netanyahu nuk arrin ta formojë qeverinë e re



TEL AVIV, 22 TETOR - Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë se nuk do të mund ta formojë qeverinë, duke i lënë mundësi rivalit të tij politik për ta bërë një gjë të tillë.

Netanyahu ka qenë në pushtet në dekadën e fundit, mirëpo ai nuk ka arritur të krijojë koalicion me shumicën, pas zgjedhjeve të mbajtura në muajin shtator.

Rivali i tij, Benny Gantz nga Partia Blu dhe Bardhë do të tentojë që të formojë qeverinë. "Unë kam bërë të gjitha përp-

jekjet për ta dërguar Benny Gantz në tavolinën e negociatave, dhe të formojë një qeveri të unitetit kombëtar, për t'i parandaluar zgjedhjet e tjera. Fatkeqësisht, ai secilën herë ka refuzuar", ka thënë Netanyahu. Presidenti izraelit Reuven Rivlin ka thënë se do t'i japë Gantzit 28 ditë për t'i kryer negociatat.

Ligjvënësit izraelitë-arabë kanë thënë se do ta përkrahin atë, mirëpo Gantz, që udhëheq aleancën e qendrës së djathtë sërish nuk siguron 61 votat e nevojshme për të krijuar shu-

micën në parlamentin me 120 ulëse.

Presidenti Rivlin ka thënë se do të tentojë shmangien e zgjedhjeve të reja, të cilat janë mbajtur dy herë gjatë këtij viti. Gantz është ish-udhëheqës i Ushtrisë izraelite dhe ka shërbyer në atë pozitë derisa Netanyahu ka qenë kryeministër. Netanyahu, në anën tjetër, ka më shumë përvojë politike, mirëpo është duke u përballur me seanca gjyqësore rreth pretendimeve për përfshirje në korrupsion.

Mbi 150 të vrarë në protestat anti-qeveritare në Irak

BAGDAD, 22 TETOR - Autoritetet në Irak bënë me dije se 157 njerëz janë vrarë në protestat e fundit antiqeveritare në Bagdad dhe qytete të tjera të këtij vendi. Gjetjet e publikuara nga ekipet hetuese zbuluan se në mesin e të vrarëve në dhunë janë 149 civilë

dhe tetë pjesëtarë të forcave të sigurisë.

Protestat në Irak janë zhvilluar javën e parë të tetorit për shkak të papunësisë, shërbimeve të dobëta publike dhe korrupsionit. Në raportin e ekipeve hetuese thuhet se vdekjet janë shkaktuar

kryesisht me armë zjarri, ndërsa ka pasur edhe shënjestime me snajperë. "Oficerët dhe komandantët e kanë humbur kontrollin mbi forcat e tyre gjatë protestave dhe kjo ka shkaktuar kaos", thuhet në raport.

Protesta të reja antiqeveritare në

Irak pritet të nisnin më 25 tetor.

Iraku ka një popullsi prej 40 milionë banorësh dhe është prodhuesi dhe eksportuesi i pestë më i madh i naftës në të gjithë botën, por shkalla e varfërisë së përgjithshme vlerësohet të jetë mbi 20 për qind.





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Lindi 368 gramë, mbijeton mrekullisht foshnja

Një foshnje që lindi rreth 368 gramë ka mbijetuar mrekullisht. Kallie Bender lindi para kohe dhe ishte vetëm 25 javëshe. Ajo ishte aq e vogël sa që unaza e martesës së babait të saj i qëndronte si një byzylyk i madh në dorë. Por Kallie sfidoi çdo shans, pasi mjekët u thanë prindërve, Ebonie e Dameon, se ajo mund të mos mbijetonte. Dhe pesë muaj pas lindjes, vajza është nxjerrë nga spitali të



hënën. Ajo tani peshon 3.1 kg. Mjekët thonë se vogëlushja tani po 'lulëzon' pasi qëndroi në kujdes intensiv për 21 javë.

FOTO E DITES



Fëmijët e një shkolle në Indi kalojnë lumin me një varkë për të shkuar në shkollë. /AP/

E rrallë

Për herë të parë në histori, Kina ia kalon ShBA-së për pasanikë

Raportimet e reja nga Credit Suisse tregojnë se numri i personave të pasur nga Kina është tashmë më i lartë se i atyre të ShBA-së për herë të parë në histori. Të dyja janë shtetet me numrin më të madh të milionerëve në botë. Këtë vit Kina ka më shumë anëtarë të 10 përqindshit të më të pasurve në botë



sesa ShBA-ja. 10 përqindëshi i njerëzve më të pasur në botë ka 100 milionë kinezë dhe 99 milionë amerikanë. Njerëzit që janë në këtë 10 përqind janë ata që zotërojnë më shumë se 109 430 dollarë.

BARSOLETA E DITËS



Hyri një grua me dy fëmijë në një kafiteri, i afrova kamerierit dhe ai e pyeti:
- Çfarë doni të pini?
Gruaja:
- Mbusheni këtë (ia jep cucllën)!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora

14:00

ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Ju do të bëni aq qejf sot sa do të harroni të shikoni nëse të tjerët rreth jush janë po aq të lumtur sa ju.



DEMI

Sot do të jeni tepër të impresionuar nga të tjerët, por kjo nuk do të thotë se duhet të rri në qetësi.



BINJAKËT

Në këtë ditë duhet ta anashkaloni pakëz të vërtetën.



GAFORRJA

Sot do të konkurroni me dikë. Mes jush ka nisur një betejë e cila nuk do të përfundojë derisa ju të arrini sukses.



LUANI

Mos hezitoni të zhyteni në çfarëdo projekti ose situatë që lidhet me dashurinë tuaj.



VIRGJËRËSHA

Mos i fryni gjërat më shumë sesa që duhet.



PESHORJA

Emocionet tuaja janë dinamike dhe ekstreme sot.



AKREPI

Do të keni një lloj frymëzimi që doni ta ndani me të tjerët.



SHIGJETARI

Dita e sotme është në favorin tuaj. Ka shumë fuqi dhe forcë pas emocioneve tuaja, të cilat nuk duhet t'i shfaqni.



BRICJAPI

Sot mund të gatuani darkë për një grup të madh.



UJORI

Mjafton ta merrni hapin e parë për një punë sot dhe pjesa tjetër do të ecë në mënyrë të përsosur.



PESHQIT

Ju mund të ndjeni një lloj presioni nga njerëzit që ju rrethojnë, të cilët duan t'ju marrin me vete në një festë.

Nicki Minaj thotë se është martuar zyrtarisht me Kenneth Petty



Nicki Minaj është zyrtarisht një zonjë. Të hënën reperja 36-vjeçare njoftoi se ajo dhe i dashuri Kenneth Petty janë martuar, duke ndarë një video në "Instagram" ku shfaqet gota që shkruajnë "Mr." dhe "Zonja", si dhe kapele "Nusja"


dhe "Dhëndri". Minaj, për të cilën pati thashetheme se do të ketë një dasmë vitin e kaluar, e zbuloi në qershor që ajo dhe Petty, 41-vjeçar, i cili u dënua për përdhunimin në tentativë të një vajze 16-vjeçare, kishin marrë leje për martesë.

Finalizohet divorci i Kates dhe Lenit



Kate Beckinsale dhe ish-burri i saj Len Wiseman janë ndarë që tre vjet, por divorci i tyre nuk u finalizua deri më tani. Në dokumentet e divorcit Kate kërkoi që bizhuteritë dhe gjërat personale t'i mbesin asaj.

Ajo gjithashtu kërkoi të mbante të gjitha fitimet pas ndarjes, sipas The Blast. Kate dhe Len u takuan në vitin 2003 dhe u martuan një vit më vonë. Ajo bëri kërkesë për divorc në tetor të vitit 2016.



Hailey Baldwin vishet si Julia Roberts te "Pretty Woman"

Vivian Ward do të ishte krenare. Hailey Baldwin kishte zgjedhur një veshje që ngjante shumë me atë të karakterit që Julia Roberts e portretizon në filmin ikonik "Pretty Woman" për festën e ditëlindjes së muzikantit dhe producentit Andrew Watt. E shoqëruar nga bashkëshorti i saj

Justin Bieber, modeluesja 22-vjeçare kishte veshur geta me rrjetë, bluzë të bardhë pa mëngë, xhinse shumë të shkurtra, vathë të mëdhenj në formë rrethore dhe çizme të gjata deri mbi gjunjë nga lëkura me ngjyrë të zezë që janë të dizajnuara nga Amina Muaddi (957 dollarë).

Dennis Quaid konfirmon fejesën



Dennis Quaid, 65-vjeçar, ka konfirmuar se është fejuar me 26-vjeçaren Laura Savoie, pasi i ka propozuar asaj fejesë në Hawaii. "Ndodhi në pikën më veriore të Oahus. Ishte spon-tane", ka thënë ai për "Extra".

"Ishte befasi". Ndërsa ai tha se gjithçka ndodhi rastësisht, Quaid pranoi se e kishte blerë unazën kohë më parë. "Unë e kisha unazën në xhep. Ka qenë në plan që një muaj e gjysmë. Doja që kjo të ishte private", ka treguar ai.

Lëvizja intelektuale dhe filozofike që dominoi botën e ideve

Pas shpërthimit të krijimtarisë në Firence gjatë shekullit XIV, e njohur si epoka e Rilindjes, bota moderne pa një shkëputje nga ajo që dikur kishte ditur: favorizoi një qasje më humaniste ndaj qenies. Idetë e Rilindjes ishin përhapur në të gjithë Evropën në shekullin e XVII-të, me artet dhe shkencat që lulëzuan jashtëzakonisht shumë, në mesin e atyre me një prirje më të logjikshme. Me mësimet e Kishës dhe mënyrat e të menduarit që tashmë eklipsoheshin prej Rilindjes, hendeku midis periudhës mesjetare dhe asaj moderne ishte ngushtuar, duke çuar në territore të reja dhe të pashpjeguara intelektuale.

Gjatë Rilindjes, mendjet e mëdha të Kopernikut (Nicolaus Copernicus), Keplerit (Johannes Kepler) dhe Galileos (Galileo Galilei) demonstuan fuqinë e studimit shkencor dhe atë të zbulimit. Përpara secilës prej shpikjeve të tyre, shumë mendimtarë kishin ruajtur mënyrat më të lashta të të menduarit, përfshirë pikëpamjen gjeocentrike ptolemaike dhe aristoteliane, sipas të cilës Toka ishte në qendër të universit tonë. Koperniku në vitin 1543 hodhi teorinë se në të vërtetë të gjitha planetët që ne njihim nuk rrotulloheshin rreth Tokës, por rreth Diellit, një sistem që u mbështet më vonë nga Galileo (për dëmin e tij). Hedhja e një teorie të tillë gjatë një kohe tensioni të lartë midis mendjeve shkencore dhe fetare u quajt herezi, dhe heretikë të tillë, që vazhdonin të përhapnin “këto gënjeshtra” duhej të ndëshkoheshin me burgim, ose edhe me vdekje. Galileo u shkishërua nga Kisha dhe u burgos për gjithë jetën, për shkak të vëzhgimeve të tij astronomike dhe mbështetjes që i bëri parimit heliocentrik.

Megjithë përpjekjet e Kishës për të kërcënuar këtë brez të ri racionalistësh, më shumë shpjegime u ofruan për mënyrën se si funksiononte universi, dhe me një ritëm që njerëzit – përfshirë Kishën – nuk mund ta injoronin më. Pikërisht me këto zbulime të mëdha lindi një lloj i ri i filozofisë, i themeluar mbi arsyen.

Dogma e kahershme e Kishës po humbiste betejën e madhe për të vërtetën, përballë racionalistëve dhe shkencëtarëve. Vetë ky fakt mishëroi mënyrat e reja të të menduarit, që përfshinë Evropën gjatë pjesës më të madhe të shekullit XVII. Shumë njerëz morën përsipër që të përpiqeshin të integronin arsyetimin dhe filozofitë shkencore, në botë. Rilindja

kishte mbaruar dhe ishte koha për një epokë të re – Epoka e Arsyes.

Shekujt XVII dhe XVIII ishin periudha të ndryshmeve rrënjësore dhe kuriozitetit. Metoda shkencore, reduksionizmi dhe vënia në dyshim e idealeve të Kishës do të inkurajoheshin, ashtu si edhe idetë e lirisë, tolerancës dhe përparimit. Veprime të tilla për të kërkuar njohuri dhe për të kuptuar informacionin tashmë në dispozicion, u rrokën nga fraza latine “sapere aude” ose “guximi për të ditur”, siç Immanuel Kanti e përdori në esenë e tij “Një përgjigje për pyetjen: Çfarë është iluminizmi”? Ishte qëllimi dhe përgjegjësia e mendjeve të mëdha, për të dalë në pararojë dhe kërkuar të vërtetën, që ata besonin se mund të gjendej vetëm tek dija.

Ata që ne sot i njohim si filozofët e parë ‘modernë’ – René

Descartes, Thomas Hobbes dhe Francis Bacon – ringjallën lidhjen midis shkencës, matematikës dhe filozofisë, që datonte nga Greqia para-sokratike. Së bashku me mendjet e tjera brilante, si Blaise Pascal dhe Gottfried Vilhelm Leibniz dhe veprat e tyre respektive, secili prej tyre besoi se mund të përftonim më mirë njohuritë për botën tonë, përmes procesit të arsytimit.

Bacon, i konsideruar gjerësisht si i pari që ndoqi mënyrën empirike britanike të të menduarit, ishte ai që kishte krijuar metodat, të cilat u mundësuan shkencëtarëve të tjerë të kryejnë më mirë eksperimente të reja në botën e re. Ai besonte se të gjitha njohuritë dhe informacionet që ne arrijmë vijnë nga përvoja fizike dhe shqisore, dhe se ishte përgjegjësia e shkencëtarëve të luftonin kundër çdo pengese që mund të shfaqej, në mënyrë që të përftoheshin njohuri të tilla. Bacon gjithashtu krijoi kornizën fillestare përmes së cilës ne ishim në gjendje të këqyrnim botën përreth nesh.

Descartes u frymëzua nga vepra e Baconit, por jo për të njëjtat arsye si vetë Bacon. Descartes u magjeps shumë nga potenciali i zgjerimit të njohurive të sapo përfutuara për botën përreth nesh. Ishte dëshira e tij për të hequr qafe skepticizmin që e kish ndjekur për kaq kohë, nga bota magjepsëse e shkencës. Ai u përpoq të zbulonte se si dhe çfarë njohurish mund të paraqiteshin, edhe kur vinin nga pozicione skepticizmi. Në “Meditimet për filozofinë e parë”, ku studioi dhe reflek-

tonte më rigorozisht mbi epistemologjinë dhe metafizikën, ai pyeste se “çfarë mund të di?” Për të e vetmja përgjigje ishte se dija e vërtetë mund të vinte vetëm nga arsyeja. Ishte kjo ide thelbësore që do të mbizotëronte në fazën e mendimit dhe besimit për shekullin pasardhës.

Megjithatë, një zbuluesë e tillë sigurisht që nuk do të pranohej si një ungjill, nga mendjet tashmë dyshuese dhe të pasigurta të Evropës së shekullit të XVIII-të. Kjo ishte Epoka e Iluminizmit. Çdo teori e re duhej të vihej në pikëpyetje, të investigohej, derisa të mos kishte dyshime mbi të. Sigurisht, asnjë teori e tillë nuk mund të ekzistonte në atë që ishte tani një fushëbetëje intelektuale.

Filozofi anglez John Locke iu kundërvu vetë strukturës së filozofisë së re të Descartesit në veprën e tij “Një ese mbi kuptimin njerëzor”. Locke besonte se ne nuk e përftojmë dijen përmes arsytimit, por përmes eksperiencës. “Dija e asnjë njeriu nuk mund të shkojë përtej eksperiencës së tij”. Nëse do të ishim në gjendje të arsyetonim mbi këtë parim, atëherë do të ishim në gjendje që të prodhonim shumë ide dhe parime të reja, që do të ndihmonin për të kuptuar ekzistencën tonë. Shpresa e tij ishte që me kalimin e kohës, ne do të ishim në gjendje të vendosnim limite specifike mbi atë që mund të dinim. Kjo ide më vonë do të bëhej e njohur si empiricizmi, që aq shumë e karakterizoi filozofinë britanike në atë kohë.

Pavarësisht qasjes shumë të ndryshme të Descartesit dhe Lockesit ndaj racionalitetit prapa mënyrës si ne përftojmë dijen, dy idetë kishin diçka jetike të përbashkët – njerëzit. Është qenia, apo njeriu, dija e të cilit e shpie drejt dijes.

Në atë shekull dhe pasardhësin, filozofët mbështetës të të dy qasjeve nisën të pyesin se si ne jemi në gjendje të dimë atë që dimë, gjë që i shtyu të ndjekin ide të vetë natyrës njerëzore. Fusha intelektuale e lojës po rritej në mënyrë eksponenciale, teksa gjithnjë e më shumë aktorë mbanin lart flamujt dhe njerëzit e zakonshëm zgjidhnin ekipin të cilit i përkisnin. Megjithatë, ashtu si me çdo filozofi të re dhe sistem besimi, ish bërë tashmë pjesë e procesit të dijes që të vlerësoje faktin që secila degë do të kishte tashmë moralin e vet, politikën e vet dhe implikimet e veta sociale.

Monarkitë dhe aristokracia e Evropës së shekullit XVIII filluan të shqetësohen për pozicionin e tyre në evolucionin e shoqërisë. Ashtu si pozicioni i fortë i Kishës ndaj njerëzve në Evropën kontinentale ishte zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme, klasat e sipërme kishin frikë se mund të ndodhte i njëjti lloj revolte kundër tyre. Nëse ata nuk do të kishin më një qëllim, çfarë saktësisht do t'i zëvendësonte në shoqëri? Sidoqoftë, nuk ishte vetëm elita që po përballlej me një tronditje. Sistemet politike në të gjithë Evropën panë t'u hapej një derë e re, një derë që çoi në krijimin e demokracive moderne liberale dhe mendimit më përparimtar. Mënyrat konservatore dhe më të rrepta të qasjes ndaj politikës dhe shoqërisë po sfidoheshin dhe lësheshin pas, në favor të idealeve gjithëpërfshirëse dhe të drejta.

Duhet thënë se Epoka e Arsyes ishte një lëvizje shpërthyesë që pushtoi mendjet e miliona njerëzve në Evropë. Ishte një periudhë kohe që inkurajoi shumë njerëz të kapeshin fort pas parimeve fillestare të Rilindjes dhe Revolucionit Shkencor. Ajo preku çdo aspekt të jetës dhe do të na shpinte ne njerëzve në shekullin e ri, me më shumë kuptim të botës se kurrë më parë. Filozofia, matematika, shkenca, politika, ekonomia dhe mjekësia po zgjeroheshin dhe përditësoheshin në mënyrë drastike, me gabime që korrigjoheshin dhe teori që vërtetoheshin. Shumë prej gjërave që dimë sot i kanë rrënjët tek Iluminizmi, dhe nuk ka asnjë dyshim mbi ndryshimin rrënjësor që ajo lëvizje i solli botës. /bota.al/



FUNDI I BOTËS SË FUNDIT



**Nga: Julio CORTAZAR
(1914-1984)**

Përktheu: Anton PAPLEKA

Meqenëse numri i shkruesve (skribëve) do të shtohet, disa lexues që mbeten nëpër botë, do të ndërrojnë zeje: edhe ata do të bëhen shkrues. Gjithnjë e më tepër, vendet do t'u përkasin shkruesve dhe fabrikave që prodhojnë bojë e letër: shkruesve ditën dhe makinave natën për të shtypur tekstet e shkruesve. Në krye të herës, shtëpitë nuk do t'i zënë më bibliotekat. Bashkitë vendosin (dhe pikërisht këtu gjërat fillojnë të marrin rrokullimën), të flirtojnë terrenet e caktuara për lojërat, për të zmadhuar bibliotekat. Pastaj u vjen radha teatrove, materniteteve, thertoreve, mensave, spitaleve. Të varfrit i përdorin librat në vend të tullave, i lidhin me çimento, ndërtojnë mure me libra dhe rrojnë në kasolle të ndërtuara

me libra. Pastaj vjen koha kur librat vërshojnë në qytete dhe përmbytin fushat, duke shtypur nën vete arat me grunjëra dhe me luledielli. Ndërmarrja Rruga-Ura mezi ia del mbanë që rrugët të mbeten të hapura midis dy mureve të stërmëdha me libra. Nganjëherë, ndonjë mur rrëzohet dhe ndodhin katastrofa të llahtarshme rrugore. Shkruesit punojnë pa pushim, sepse njerëzimi i respekton prirjet dhe më në fund materialet e shtypura mbërrijnë në breg të detit. Presidenti i Republikës flet në telefon me presidentë të tjerë të republikave dhe propozon me mençuri të madhe që të hidhen në det librat e tepërt. Kjo gjë bëhet njëkohësisht në të gjitha brigjet e botës. Kështu, shkruesit siberianë i shohin tekstet e tyre të hedhura në Oqeanin e Akullit, ashtu si shkruesit indonezianë etj. Kjo gjë u jep mundësi shkruesve të shtojnë për njëfarë kohe prodhimtarinë

e tyre, sepse në tokë përsëri ka vend për t'i stokuar librat. Atyre nuk u shkon në mendje se deti ka një fund dhe se në fund të detit tekstet e shtypura fillojnë të grumbullohen, së pari, në trajtën e një brumi ngjites, pastaj në trajtën e një brumi që mblidhet tok. Më së mbrami, ai brumë shndërrohet në një platformë të qëndrueshme, ndonëse veshulllore që përditë ngrihet lart disa metra, derisa vjen koha që nxjerr kokën mbi syprinën e ujit. Atëherë, disa dete përmbytin shumë toka, ndodh një ndarje e re e kontinenteve dhe e oqeanëve. Presidentët e republikave të ndryshme zëvendësohen nga liqene dhe nga gadishuj. Ca presidentë të republikave të tjera shohin sesi hapen territore të paana para ambicieve të tyre dhe kështu me radhë. I detyruar me forcë të shpërndalet, uji i detit avullohet më shpejt, kështu që një ditë kapitenët e anijeve të linjave të mëdha vënë re se vaporët e tyre lundrojnë më

ngadalë: nga tridhjetë nyja, shpejtësia e tyre zbret në njëzet, pastaj në pesëmbëdhjetë nyja, motorët gulçojnë dhe helikat shtrembërohen. Më në fund, të gjitha anijet ndalen në disa pika të deteve ta ndryshme, të ngecura në brumin e sajuar nga tekstet e shtypura. Shkruesit e mbarë botës shkruajnë me mijëra tekste të mbushura me hare për të shpjeguar këtë dukuri. Presidentët dhe kapitenët vendosin t'i shndërrojnë anijet në ishuj dhe në kazino. Publiku ecën në këmbë nëpër dete kartoni deri tek ishujt ku ca orkestra tipike e të modës e magjepsin ajrin e kondicionuar ku vallëzohet deri në orët e vona të natës. Përsëri tekstet e shtypura bëhen piring nëpër brigje, por kësaj here nuk ka mundësi t'i hedhësh në brumin e ujshëm. Kështu ngrihen murishta dhe krijohen male buzë deteve të lashta. Shkruesit e kuptojnë se fabrikat e bojës e të letrës do të falimentojnë. Ata shkruajnë me një

shkrim gjithnjë e më të imët, përdorin zgëqet më të padalueshme të çdo flete letre. Kur mbaron boja, ata përdorin lapsa. Kur mbaron letra, ata shkruajnë në pllaka, në rrasa etj. Përhapet zakoni për të ndërkallur një tekst në një tekst tjetër, për ta shfrytëzuar hapësirën midis rreshtave ose i fshijnë me tehun e brisikut të rrojës faqet e shtypura më parë për t'i përdorur sërish. Shkruesit punojnë me një ritëm të ngadalësuar, por ata janë në një numër aq të madh, saqë, për shkak të teksteve të shtypura, tokat ndahen përfundimisht nga shtrati i deteve të lashta. Në tokë, raca e shkruesve rron në zgrrip. Ajo është e dënuar të shuhet. Në dete, ka ishuj e kazino, domethënë transatlantikë ku janë strehuar presidentët e Republikave. Aty bëhen festa të mëdha dhe shkëmbehen mesazhe nga ishulli në ishull dhe nga një president te një president tjetër, nga një kapiten te një kapiten tjetër.



QENDRA SPORTIVE
 "BUJQËSIA"
 TEL: 045/82 82 82

13 gjimnastë e përfaqësojnë Kosovën në Slloveni

Tetë gjimnaste dhe pesë gjimnastë do ta përfaqësojnë shtetin e Kosovës në garën ndërkombëtare që mbahet në Slloveni. Kryetari i FGJK-së, Besim Halilaj, ka thënë se kjo garë do t'i shërbejë Kosovës për të ardhmen. "Pjesëmarrja në këtë garë është diçka pozitive për gjimnastikën e Kosovës, pasi Federata e Gjimnastikës, më në fund, ka arritur ta mobilizojë një ekip solid për të marrë pjesë në aktivitetet ndërkombëtare. Ne nuk presim rezultate shumë të larta për shkak se kemi filluar vonë të mobilizohemi si Kosovë dhe konkurrenca do të jetë mjaft e fortë", ka thënë Halilaj



mënyrë sa më të mirë dhe ne kemi vendosur të shkojmë vetëm në disiplinat ku ata mund të përforcojmë më së miri. Në secilën disiplinë që nuk marrim pjesë do të kemi minues pikë, prandaj edhe pritjet për rezultate të mëdha nuk i kemi. Megjithatë, mund të marrim rezultate të mira garueset më të reja në moshë", ka shtuar Halilaj. Numri një i FGJK-së sheh dika shumë pozitive nga kjo garë që mbahet në qytetin e Mariborit. Ai beson se në të ardhmen Kosova do ta ketë më të lehtë të kërkojë medalje në garat ndërkombëtare, pasi dalëngadalë është duke e

fituar përvojën që i ka munguar. "Pjesëmarrja në këtë garë do t'i shërbejë pikërisht të ardhmes dhe ky është qëllimi ynë kryesor. Garuesit tanë e kanë shumë të rëndësishme daljen në gara jashtë Kosovës, për faktin se ka rregulla të prera dhe ka takime me gjimnastët e tjerë, ku edhe konkurrenca është e nivelit të lartë. Kjo do t'i ndihmojë gjimnastët tanë të jenë të përpiktë sikurse që është sporti i gjimnastikës", ka deklaruar ai. Halilaj ka folur edhe për organizimin për pjesëmarrje në këtë garë dhe, sipas tij, kjo nuk ka qenë e lehtë sepse financat vazhdojnë të

jenë problemi kryesor për federatën që ai e drejton. "Organizimi për pjesëmarrje në këtë garë nuk është edhe aq i lehtë, sepse nuk po qëndrojmë mirë financiarisht. Jemi duke punuar me buxhetin e tremujorit të parë, kurse pjesët e tjera financiare ende nuk janë kryer, ani pse jemi ndër të parët prej federatave që e kemi dorëzuar planin në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Nga ana e çështjeve teknike qëndrojmë mirë", ka përfunduar Halilaj. Gjimnastet e Kosovës edhe më herët kanë marrë pjesë në garat ndërkombëtare në Slloveni, Itali dhe Maqedoni.

EPOKA E RE **Veton ZYMBËRI**

PRISHTINË, 22 TETOR - Trembëdhjetë gjimnastë nga Kosova do të marrin pjesë në garat e gjimnastikës që do të zhvillohen për tri ditë me radhë në qytetin e Mariborit në Slloveni. Ekspedita e Kosovës do të nis sot (e mërkurë) drejt Sllovenisë me shpresë që të ketë paraqitje sa më të mirë në këtë garë ndërkombëtare, që për Kosovën është një gjë e madhe për faktin se ky sport ka filluar me vonesë të mobilizohet. Redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re" e ka kontaktuar të martën kryetarin e Federatës së Gjimnastikës së Kosovës, Besim Halilaj, i cili është shprehur mjaft i lumtur se gjimnastët e Kosovës do

ta kenë rastin të marrin pjesë në garat ndërkombëtare. Halilaj ka thënë se nuk priten rezultate të jashtëzakonshme në këtë garë për faktin se konkurrenca është e fortë. "Pjesëmarrja në këtë garë është diçka pozitive për gjimnastikën e Kosovës, pasi Federata e Gjimnastikës më në fund ka arritur ta mobilizojë një ekip solid për të marrë pjesë në aktivitetet ndërkombëtare. Ne nuk presim rezultate shumë të larta për shkak se kemi filluar vonë të mobilizohemi si Kosovë dhe konkurrenca do të jetë mjaft e fortë", ka thënë Halilaj. "Ne do të marrim pjesë me 13 garues. Tetë prej tyre do të jenë vajza dhe pesë meshkuj, kurse gara do të zgjasë tri ditë. Garat do të jenë ekipore dhe secili gjimnast duhet të përformojë në

Eris Bllaca: Do t'i shënojmë mbi 20 gola

"Jam në formë të mirë. Në shtatë ndeshje kam shënuar shtatë gola. Do të përpiqem që ta shpërblej besimin e klubit dhe në secilën ndeshje ta jap maksimumin duke shënuar edhe gola. Në fund besoj se do ta kaloj shifrën e 20 golave", ka thënë Bllaca për "Epokën e re"



PRISHTINË, 22 TETOR - Futbollisti Eris Bllaca ka shënuar tre gola nga penalltia në ndeshjen e fundit që Kosova e Prishtinës e luajti 4-4 ndaj Vjosës në Ligën e Tretë. Një gjë të tillë e kishte bërë edhe sulmuesi më i mirë në edicionin e kaluar, Kastriot Rexha, që kishte shënuar tre gola nga penalltia ndaj KEK-ut.

Futbollisti Bllaca, i cili mund të luajë si mesfushor i djathtë dhe sulmues, ka thënë se synim e ka që në këtë kampionat ta mbyllë të paktën me 20 gola të shënuara. "Jam në formë të mirë. Në shtatë ndeshje kam shënuar shtatë gola. Do të përpiqem që ta shpërblej besimin e klubit dhe në secilën ndeshje ta

jap maksimumin duke shënuar edhe gola. Në fund besoj se do ta kaloj shifrën e 20 golave", ka thënë Bllaca për "Epokën e re". Karrierën 20-vjeçari e nisi në moshën nëntëvjeçare në skuadrën e Kosovës së Prishtinës, duke qenë pjesë edhe e grupmohave të Përfaqësueses së Kosovës. Momentalisht ky futbollist nuk është i ftuar nga Përfaqësuesja, por synimet për të ardhmen i ka të mëdha, fillimisht të luaj në Superligën e Kosovës e më pas edhe në Evropë. "Kam pasur ftesë nga skuadra e Bashkimit por, për shkak të largësisë, nuk e

kam pranuar ofertën e tyre. Do të përpiqem të dëshmojmë në këtë edicion dhe synim e kam fillimisht Superligën e Kosovës e më pas daljen në Evropë, që është synim i çdo futbollisti", ka shtuar ai. Anëtar i Kosovës së Prishtinës synime të mëdha ka edhe me klubin aktual ku synon të inkuadrohet në Ligën e Dytë. "Jemi duke punuar mjaft me trajnerin Naim Pevqeli. Do të japim maksimumin që të inkuadrohemi një rang më lart. Tash jemi në pozitën e dytë me një pikë më pak se Vjosa", ka shtuar Bllaca.

Fitore e mundimshme e 'Niklit' ndaj Vushtrrisë

Vushtrri, 22 tetor - Skuadra e Feronikeli mezi e ka mposhtur Vushtrrinë (0-1) në ndeshjen e zhvilluar të martën në kuadër të javës së njëmbëdhjetë në IPKO

Superligën e Kosovës në futboll. Pavarësisht prej dominimit në pjesën e parë dhe të dytë, "Nikli" golin e fitores e gjeti vetëm në minutën e tretë shtesë kur

Besmir Bojku realizoi për 0-1. Pas këtyre tri pikëve skuadra kampione e Kosovës është në pozitën e pestë me 19 pikë, kurse Vushtrria mbetet e fundit me vetëm 6 pikë.

Duhet cekur se Vushtrria para kësaj ndeshje e ka shkarkuar trajnerin Antonio Toma, kurse skuadra është drejtuar nga ndihmësi i tij Fitim Llapashtica.

IPKO SUPERLIGA
Vushtrria-Feronikeli (0-1)
 Të mërkurën takohen:
 Trepça '89 - Ferizaj
 Gjilani - Llapi
 Drenica - Dukagjini
 Të enjten takohen:
 Ballkani - Flamurtari
 Prishtina - Drita

'Paris 2024', zbulohet logoja e Olimpiadës franceze

PARIS, 22 TETOR - Pas një viti do të zhvillohen Lojërat Olimpikë "Tokio 2020", por vazhdon puna edhe për Olimpiadën që do të zhvillohet pas pesë vjetësh në Paris. Organizatorët e Olimpiadës "Paris 2024"

përmes një ceremonie të zhvilluar në kryeqytetin francez kanë zbuluar logon e kësaj ngjarje olimpikë. Në qendër të një rrethi ndodhet fytyra e një femre, e vizatuar përmes flakës olimpikë. Ajo femër quhet

Marianna, një nga simbolet e Republikës së Francës. Kjo logo është frymëzuar edhe nga Olimpiada e vitit 1924, organizuar po në Paris. "Medalja, flaka olimpikë, Marianna. Të gjitha këto detaje që spikatin në

logo përfaqësojnë idenë tonë për t'i vendosur personat në qendër të Lojërave Olimpikë", ka thënë Tony Estanguet, ish-atlet francez, përgjegjës për organizimin e Olimpiadës parisienne.



Sigal Prishtina pret një edicion të suksesshëm në FIBA Europe Cup



PRISHTINË, 22 TETOR - Sigal Prishtina të mërkurën (ora 19:00) do të përballë me Apoel Nicosia në ndeshjen e parë të grupeve për këtë edicion në FIBA Europe Cup. "Bardhekaltrit" janë përgatitur maksimalisht për këtë ndeshje si dhe për edicionin e ri në FIBA Europe Cup. Pjesë e këtij grupi janë edhe Ventspils e Letonisë dhe medi Bayreuth e

Gjermanisë. Prishtina edicionin e kaluar fitoi titullin në Kosovë, Kupën dhe Superkupën. Gjithashtu, në edicionin e kaluar arriti suksesin më të madh në FIBA Europe Cup, duke arritur në Top 16, kurse hera e parë që mori pjesë në këtë garë ishte viti 2015. Apoel ka përfunduar në vendin e tretë edicionin e kaluar në Ligën e Qipros, derisa

ylli i grupit është Dardan Berisha i Sigal Prishtinës. Kampionët e Kosovës shpresojnë të kenë një edicion sa më suksesshëm në FIBA Europe Cup. Prishtinasit morën pjesë edhe në kualifikimet e Ligës së Kampionëve. Sigal Prishtina-Apoel Nicosia zhvillohet të mërkurën nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë.

Derbi kosovar në Ligën Ballkanike



PEJË, 22 TETOR - Sot (e mërkurë) nga ora 19:00 do të zhvillohet derbi i skuadrave të Kosovës, Pejës dhe Rahovecit në Ligën Ballkanike. "Verdhezinjtë" rikthehen në Ligën Ballkanike pas një mungese dyvjeçare derisa ky është edicioni i parë i "vreshtarëve" në këtë ligë. Ndeshja do të zhvillohet në

palestrën "Karagaçi" dhe pritet të jetë shumë interesante ku pejanët, pas rikthimit në Superligë, janë rikthyer edhe në BIBL, kurse rahovecasit do të përpiqen të kenë një paraqitje sa më të mirë në pjesëmarrjen e tyre të parë, me shpresë se do të arrijnë të triumfojnë në këtë ligë. Më herët pjesë e kësaj lige

ishin edhe Sigal Prishtina, Bashkimi dhe Trepça. Suksesi më të madh e ka Prishtina që ka triumfuar dy herë në këtë garë. Peja dhe Rahoveci ballafaqohen për herë të parë në këtë edicion. Në Superligë "verdhezinjtë" kanë tri fitore dhe dy humbje, kurse "vreshtarët" katër fitore dhe një humbje.

SHKURT

Khaka: Evra duhet të jetë më i kujdesshëm në ato që thotë

Legjenda e Manchester Unitedit, Patrice Evra, i quajti lojtarët e Arsenalit bebe, duke u shprehur se po thotë vetëm të vërtetën dhe nuk ka aspak mungesë respekti. Menjëherë pas këtyre fjalëve ka reaguar edhe kapiteni i Arsenalit, Granit Xhaka. "Unë kam shumë respekt për të, pasi ai ka qenë një lojtar i shkëlqyer. Por, duhet të jetë më i kujdesshëm në ato që thotë. Mua më duket diçka e çuditshme kjo, pasi edhe ata kanë qenë në të njëjtën pozitë si ne. Evra i kupton këto, pasi ai ka qenë vetë lojtar. Ndonjëherë ne jemi mirë, ndonjëherë jo, por çdo javë ata kanë kritika ndaj nesh. Nuk është hera e parë që francezi flet keq për ne. Unë po jua them të vërtetën sinqerisht. Nuk jemi aspak të interesuar se çfarë thonë të tjerët, në vetëm shikojmë skuadrën tonë, për t'u përmirësuar akoma më shumë", ka thënë Xhaka.

Emre: Nuk është befasi që Evropa po e kërkon Muriqin

Ish-mesfushori i Interit dhe Atletico Madridit, Emre Belozoglu, e ka lavdëruar sulmuesin e Kosovës, Vedat Muriqi. Mesfushori turk ka thënë se nuk është befasi që skuadrat e mëdha evropiane interesohen për Muriqin. "Vedat Muriqi është golashënues i madh. Nuk është befasi që po e kërkon Evropa dhe që gjigantët e kanë në radar. Ai meriton këtë vëmendje. Besoj se ai do t'i shërbejë fanellës verdhekaltër për disa vjet dhe do të ketë sukses", ka thënë Emre.

Bayerni e kërkon Umtitin

Nicklas Sule është lënduar dhe pritet të mungojë për një kohë të gjatë. Mbrojtësi këputi ligamentin në gjurin e majtë në sfidën ndaj Augsburg dhe, sipas raportimeve nga Gjermania, Sule e ka mbyllur sezonin. Bayerni tash po e kërkon një mbrojtës dhe emri më i përfolur është ai i Samuel Umtitit, i cili te Barcelona nuk po gjen hapësira. Oferta e Bayernit do të bëhet në afatin kalimtar të janarit dhe ish-mbrojtësi i Lyonit mund të transferohet në Bundesliga.

Gattuso, afër Torinos

Genaro Gattuso ka marrë shumë oferta pas përfundimit të aventurës së tij me ekipin e Milanit. Ish-trajneri deri më tani ka refuzuar dy oferta nga Genoa dhe Sampdoria. Por për teknikun pritet të vijë një ofertë e re nga ekipi i Torinos, që nuk po kalon një moment të mirë në kampionat. Fitorja e fundit e ekipit "granata" daton më 26 shtator në sfidën ndaj Milanit. Sipas së përditshmes italiane "Tuttosport", trajneri aktual, Walter Mazzarri, është vënë në rrezik. Deri më tani nuk ka asgjë konkrete, por mësohet se Mazzarri ka një javë kohë për ta nxjerrë ekipin nga kriza.

Leganesi shkarkon trajnerin

Mauricio Pellegrino nuk është më trajneri i Leganes. Lajmi është konfirmuar nga vetë klubi i La Ligas, që ka deklaruar se mes palëve është arritur një marrëveshje për prishjen e kontratës. Leganes është duke kaluar një çast të vështirë në kampionat, pasi renditet në vendin e fundit dhe nuk ka regjistruar asnjë fitore në 9 takime të luajtura. Pellegrino u emërua në stolin e skuadrës nga Madridi verën e vitit 2018, duke bërë një sezon të parë shumë të mirë e duke u renditur në vendin e 13 me 45 pikë. Më herët tekniku argjentinas ka drejtuar Valencian, Alavesin si dhe Southamptonin në Premierë Ligë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION



QENDRA E KOMPETENCËS "KUJTIM KRASNIQI" MALISHEVË
 CENTRE OF COMPETENCE "KUJTIM KRASNIQI" MALISHEVË

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës, dhe sipas nenit 12 Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë shpall:

Nr:554/1
 Dt: 22.10.2019

Konkurs

Për regjistrimin e vijuesve për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve, për klasë e X- të në profilin:

1. TIK

Në këtë afat do të pranohen 32 kandidatë për vijimin e Arsimin dhe Aftësimin për të rritur.

Afati do të jetë i hapur nga data 23.10.2019 e deri më 23.11.2019.

Kushtet

- Regjistrimi i vijuesve në programin "Arsimin për të rritur" bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt, siç është paraparë në nenin 10.2 pikat (a, b) dhe nenit 17.3 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë.

-Në programin "Arsimi për të rritur" në shkollat e mesme të larta vijuesve ju mundësohet që një vit të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18 javë mësimi [UA nr. 12/2011 MASHT].

Për regjistrim kanë të drejtë të gjithë të interesuarit të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

1. Dëftesat e klasave të kryer paraprake
2. Certifikatën e lindjes
3. Fletëpagesën prej 150€ për regjistrimin e klasës së 10

Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimin të mesëm të lartë është me pagesë, participimi bëhet në bazë të Udhëzimit Administrativ, MASHT Nr. 11/2011

Pagesa e vijuesve për vijimin dhe përfundimin e arsimin dhe aftësimin për të rritur në shkollat e mesme të larta profesionale do të jetë :

1. Për regjistrim të vitit për një klasë, dhe punë praktike _____ 150.00€
2. Për ç' do provimin diferencial nga _____ 10.00€
3. Për provimet përfundimtare të klasës (certifikata dhe diploma) _____ 50.00€

Vijuesit të cilët ndërrojnë profilin do të i nënshtrohen provimeve diferenciale bazuar në UA 12/2011.

Kandidatet të cilët e ndërrojnë drejtimin janë të obliguar që paraprakisht të nënshtrohen provimeve plotësuese dhe diferenciale.

Dhënia e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë nga vijimi i klasës për të cilën kandidati është paraqitur për regjistrim.

Diplomat që merren në programin "Arsimi dhe aftësimi për të rritur" janë të barasvlerëshme me diplomat e arsimin formal.

Konkursi është i hapur 30 ditë, nga dita e publikimit në mjeteve të informimit publik.



Komuna Malishevë
 Drejtoria për Arsim dhe
 Edukim

Gjimnazi "Hamdi Berisha"
 Malishevë



Nr.Protokollit:121 /2019

Data : 21.10.2019

Vendi: Malishevë

OFERTË

Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë njofton të gjithë operatorët ekonomik të cilët janë të interesuar për aplikim se:

Lëshohet në shfrytëzim (Qera), hapësira për hapjen e byfësë në Gjimnazin "Hamdi Berisha" për periodën 2+2 vjeqare në kapacitetin prej 1700 nxënës dhe 100 profesor

Të gjithë operatorët ekonomik të cilët janë të interesuar për marrjen në shfrytëzim të hapësirës për hapjen e byfësë në Gjimnazin "Hamdi Berisha" do t'u nënshtrohen kriterëve të poshtë shënuara:

- Operatori duhet të ketë biznesin e regjistruar në Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe të jetë tatimpagues i rregullt në Administratën Tatimore të Kosovës.
- Kapaciteti i tij duhet të siguroj plotësimin e nevojave ditore për të gjithë stafin dhe nxënësit e shkollës.
- Operatori duhet të ketë përvojë së paku 5 vjeqare në fushën e gastronomisë
- Të ketë të paguar tatimin në pronë
- Të ketë në stafin e tij punëtorë të kualifikuar/certifikuar në fushën e gastronomisë
- Të mos ketë ndonjë të afërm nga familja të punësuar në Gjimnazin "Hamdi Berisha"
- Çmimi i qirasë së restaurantit që pretendoni të paguani.
- Çmimet e produkteve të kuzhinës. *Kërkohet: Lista e produkteve të kuzhinës që do të shërbehen në byfë dhe çmimet për secilin produkt, përfshirë edhe sasia e ushqimit që do të servohet, e matur me kilogram (kg. , gr.).*
- Të bëjë një ofertë me zbritje për stafin e mësimdhënësve.
- Ofrimi i një asortimenti të gjerë të produkteve. *Kërkohet: lista e produkteve të cilat do të shërbehen në byfë*
- Cilësi e garantuar në produkte dhe shërbim. *Kërkohet: Kontrollimi i ushqimit në baza ditore për minimizimin e rreziqeve të helmimit dhe problemeve shëndetësore të nxënësve dhe stafit.*
- Cilësia e shërbimeve
- Dëshmia profesionale (certifikata, diploma) për fushën e hotelierisë të stafit të operatorit ekonomik
- Përvoja e punës në këtë fushë
- Kualifikimet e punëtorëve dhe të tjera... *ju lutemi specifikoni nëse keni dëshmi të tjera profesionale.*
- Numri i nxënësve me asistencë sociale të liruar nga pagesa. *Kërkohet: Specifikoni numrin e nxënësve të cilët do t'i lironi nga pagesa nëse e fitoni të drejtën për shfrytëzimin e byfësë.*

Të gjithë të interesuarit materialin dhe informatat e nevojshme shtesë mund t'i marrin në shkollë nga ora 8:00-15:00.

Aplikimi fillon nga data 22/10/2019 deri me 04/11/2019

Hapja e ofertave bëhet me datën : 04/11/2019 nga ora 11:00

Vërejtje: Çdo operatorë ekonomik i cili aplikon dhe nuk i përmbushë kriteret të cilat janë specifikuar nga Gjimnazi "Hamdi Berisha" nuk do të merren parasysh nga komisioni vlerësues.

Fituesi i tenderit do të përcaktohet nga totali i pikëve të fituara.

Malishevë
 Më 21.10.2019



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas
Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/609
Më: 21.10.2019
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASIIT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASIIT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin fillor të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2019/2020.

1.SHFMU "Fetah Sylejmani"- Dragash

1. Një mësimdhënës për mësim klasor – Shajnc (deri sa punëtorja të kthet nga pushimi i lehonisë)

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.);
 - Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
 - Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj;
 - Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar;
 - Certifikata që nuk jeni nën hetime;
 - Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).
- Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2019, por në varësi të lirimit real të vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë: 21.10.2019
Dragash

Drejtori i DKA-së
MSc. Vloran Cenaj

Poziv za izražavanje interesa

Škola/Opština: METO BAJRAKTARI, REČANE, PRIZREN

Datum: **23.10.2019**,

Naziv ugovora: Negovanje i poštovanje svoje i kulture drugih zajednica na Kosovu

Broj ugovora: **ESIP/SDG/087-CS/1.15**

Vlada Kosova je dobila kredit od grupe Svetske banke za Projekat poboljšanja obrazovnog sistema (PPOS), i namerava da deo sredstava iz ovog kredita izdvoji za podršku Ministarstvu obrazovanja, nauke i tehnologije i ONSŠ "METO BAJRAKTARI", PRIZREN. Kao deo ove podrške sledeća nabavka potrebne opreme će se odvijati:

1. Opis potrebne usluge:

Nabavka laptopova za potrebe škole

2. Minimalni kriterijumi za kvalifikovanje izvođača radova da imaju pravo da se prijave su:

- Uspešno iskustvo u izvršenju najmanje 1 ugovor o robu slične prirode tokom poslednje dve godine;
- Pravna registracija firme od strane lokalnih vlasti.

3. Zainteresovani izvođači koji ispunjavaju navedene minimalne kvalifikacione uslove su dobrodošli da se prijave sa svojim izražavanjem interesa za detaljne tehničke specifikacije na adresi ONSŠ "Meto Bajraktari" u Rečanu, 20530 Rečane, najkasnije do 31.10.2019. godine, do 14,00 časova.

4. Detaljna tehnička specifikacija, zajedno sa drugim uslovima, sve pripremljeno u jednom dokumentu pod nazivom Poziv za dostavu ponude za robu će biti dostavljeni od strane škole samo za one izvođače koji ispunjavaju kriterijume. Kompanije se mole da dostave svoje kontakt podatke prilikom podnošenja svog interesovanja.

Kontakt detalji škole: Esad Kurejšepi,
+383 44 389 144 ,
meto.bajraktari@outlook.com



Poziv za izražavanje interesa

Škola/Opština: METO BAJRAKTARI, REČANE, PRIZREN

Datum: **23.10.2019**,

Naziv ugovora: Negovanje i poštovanje svoje i kulture drugih zajednica na Kosovu

Broj ugovora: **ESIP/SDG/087-CS/1.15**

Vlada Kosova je dobila kredit od grupe Svetske banke za Projekat poboljšanja obrazovnog sistema (PPOS), i namerava da deo sredstava iz ovog kredita izdvoji za podršku Ministarstvu obrazovanja, nauke i tehnologije i ONSŠ "METO BAJRAKTARI", PRIZREN. Kao deo ove podrške sledeća nabavka potrebne opreme će se odvijati:

1. Opis potrebne usluge:

Nabavka laptopova za potrebe škole

2. Minimalni kriterijumi za kvalifikovanje izvođača radova da imaju pravo da se prijave su:

- Uspešno iskustvo u izvršenju najmanje 1 ugovor o robu slične prirode tokom poslednje dve godine;
- Pravna registracija firme od strane lokalnih vlasti.

3. Zainteresovani izvođači koji ispunjavaju navedene minimalne kvalifikacione uslove su dobrodošli da se prijave sa svojim izražavanjem interesa za detaljne tehničke specifikacije na adresi ONSŠ "Meto Bajraktari" u Rečanu, 20530 Rečane, najkasnije do 31.10.2019. godine, do 14,00 časova.

4. Detaljna tehnička specifikacija, zajedno sa drugim uslovima, sve pripremljeno u jednom dokumentu pod nazivom Poziv za dostavu ponude za robu će biti dostavljeni od strane škole samo za one izvođače koji ispunjavaju kriterijume. Kompanije se mole da dostave svoje kontakt podatke prilikom podnošenja svog interesovanja.

Kontakt detalji škole: Esad Kurejšepi,
+383 44 389 144 ,
meto.bajraktari@outlook.com



Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Zenuni"

Komuna: **Dragash**

Data: **23.10.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/007-G/1.2	Furnizimi me aparate teknologjike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Zenuni" Brod, Dragash. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

Furnizimi me aparate teknologjike

- **Lap topa 3 copa**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Zenuni" Brod, Dragash, më së largu deri më **31.10.2019**.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur **Ftesë për ofertë-Mallra**, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Cenan Skenderoski
Telefoni: 044/494 155
E-maili: cenanbrod@hotmail.com

Republika e Kosovës
PËRMABRUESI PRIVAT
Fatos Shatri
i emëruar për territorin e
Gjykatës themelore
Pejë

Adresa: Rruga "Fadil Ferati" p.n. Istog
Tel: 039-450-568 & 044-434-700
Email: fatos_shatri@hotmail.com

Pnr.89/2018

Në çështjen e përmbarimit të kreditorit Procredit Bank, me përfaq. Debt Loan Recovery L.L.C, Rr."Rrustem Statovci" nr.29, Prishtinë, për përmbarimin e borgjit lëndor sipas kontratës së kredisë nr.16245, e datës 31.07.2006, si dhe Aktvendim mbi regjistrimin e Hipotekës nr.Protokollit 260/06, I dt.28.07.2006, në shumën prej 12.094.15 euro, për përmbarimin datë.02.03.2018 duke vendosur sipas propozimit të kreditorit për përmbarim të dhunshëm me shitje publike të patundshmërisë së debitorit në bazë të nenit 221-240 të LPP më datë 04.10.2019 nxjerr këtë:

KONKLuzion MBI SHITJEN E PALUAJTSHMËRISË

CAKTOHET shitja publike për herë të parë e paluajtshmërisë dhe atë me sa vijon:
Ngastra kadastrale nr.2539/5 në sipërfaqe prej 00-00-26 ha, me kulturë Shitore-Dyqan, Z.K. Gjakovë-Qytet nr.70705029, numri I fletëposeduces me nr.796, me pronar Him (Jahir) Bytyqi, me përfaqësues Gjylshah Hysenaj e caktuar sipas aktvendimit PPP.nr.29/2018 i dt.21.05.2018 i Gjykatës Themelore Gjakovë. Vlera e kësaj paluajtshmërie sipas vlerësimit të ekspertit kap shumën prej 15.000.00 (pesëmbëdhjetëmijë) euro, përkatësisht 576.92 euro për ari.

Shitja publike do të mbahet me datë 04.11.2019 duke filluar nga ora 10:00 në zyrën e përmbaruesit në Istog, rruga "Fadil Ferati" p.n. Cmimi fillestar nga i cili do të filloj shitja publike e paluajtshmërisë është 15.000.00 (Pesëmbëdhjetëmijë euro) euro cmim ky i vlerësuar nga ekspertit.

Në ankandin e dytë të shitjes publike, paluajtshmëria mund të shitet nën vlerën e përcaktuar, por jo nën gjysmën e kësaj vlere.

Ofertuesit me rastin e aplikimit duhet të depozitojnë në llogarinë e veçantë të Përmbaruesit vlerën në shumën prej 1/10 të vlerës së përgjithshme të paluajtshmërisë por jo më tepër se 5.000.00 euro.


Në këtë shitje publike kanë të drejtë pjesmarje të gjithë qytetarët dhe personat juridik.

Paluajtshmëria do t'i shitet personit I cili jep cmim më të lartë dhe pas pagesës së këtij cmimi do të bëhet e mundur ndërrimi I pronarit pranë DGJK në Istog, ku blerësi do të shënohet si pronar I kësaj pasurie.

Ofertuesit të cilët do t'i shitet pasuria, ka për detyrë që ta depozitoj cmimin e shitjes brenda afatit prej 30 ditësh në llogarinë e posaçme të përmbaruesit, nga dita e pranimit të konkluzionit mbi shitjen e paluajtshmërisë.

Në Istog më datë 04.10.2019

Përmbaruesi privat - Fatos Shatri



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Kosovo Cumhuriyeti
Ministria e Shëndetësisë
Ministertvo Zdravstva i Kosovës
SHSKUK - УБЕЗК - КОВИКИ
SPITALI I PËRGJITHSHËM-OPŠTA BOLNICA-GENEL HASTANE
"Prim. Dr. Daut Mustafa"


Njësisë Org. Org.Jedinična Org.Böllumü Nr.i faqëve Etazarična Sayfa no. I Nr.Prof. Br.Prof. Prot.No. Data: 21.10.2019 Prizren

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova - Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA"
Prizren

Bazuar në Shkresën e SHSKUK-së, nr. 2934, të datës, 21.10.2019 dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" Prizren, nr. 7/201, të datës 21.10.2019, Zyra e personelit:

NJOFTON

Anuloheh në tërësi Konkursët publike të shpallura nga data 11.09.2019 e këndej me nr. 8/39, datë 30.09.2019, nr. 8/40, datë 30.09.2019, nr. 8/41, datë 03.10.2019, dhe nr. 8/42, datë 04.10.2019.



Shpall ë pavlefshme certifikatën e biznesit
BARDHI CLUB B.I. N.SH. "BARDHI CLUB" nr. biznesit 70494892 Gillogoc biznes individual.

Shpall të pavlefshme Certifikatën e biznesit
Autolarje Bardhi B.I. D.SH. Autolarje
"BARDHI" nr. biznesit 70644843 Skenderaj.
Biznes Individual.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<


- Loresa Sadriu shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Shtjefan Gjeqovi" Prishtinë.
- Elmedina Haziri shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Shtjefan Gjeqovi" Prishtinë.
- Petrit Drenica shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të I,II,III,IV si dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Xheladin Deda" Mitrovicë.
- Fisnik Sada shpall te pa vlefshme diplomën e Gjimmnazit " Hajdar Dushi " në Gjakovë.
- Valon Sylmetaj shpall te pa vlefshme certifikatën për Furrтари lëshuar nga Q.A.P. në Prizren
- Antigona Muhadri shpall te pa vlefshme dëftesën e plotë të Sh.F.M.U. "Pjeter Bogdani" në Demjan - KK Gjakovë.
- Shqipron Januzi shpall të pavlefshme diplomën e SHMT "Anton Çetta" Skenderaj drejtimi: kimi, teknologji.
- Amir Mecinaj shpall të pavlefshme diplomën e SHMT "Anton Çetta" Skenderaj, drejtimi komunikacion rrugor.
- Florentina Dragaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të Farmacisë "Xheladin Deda" Mitrovicë.
- Kërkoj shporet për nxehe qendrore me dru të përdorur, që mundet të ngrohe deri 1000 m2, numri kontaktues 044-608-626.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçantë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139


Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpeite



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC COLA
Columbus, Georgia, USA
Since 1909